

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7612 E hënë 6 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga EDMOND HAXHINASTO

**K**am ndjekur me vëmendje diskutimet e fundit në lidhje me shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë dhe, siç ndodh shpesh mes shqiptarësh...

Vijon në faqen 19

Shkëmbim territorësh Serbi-Kosovë, modelet që u diskutuan nga Meta e Xhinxhiç në 2002



Opinion

Ditës

Nga SPARTAK TOPOLLAJ

**P**ak ditë më parë, zvkryeministri i Parë e njëkohësisht ministër i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, brenda të gjitha rregullave diplomatike, kërkoi leje nga...

Vijon në faqet 20-21

Kur edhe Ivica Daçiç tenton të japë leksione qytetarie!



Mediat serbe: Ushtria jonë, e gatshme në të gjithë territorin

## Paralajmërimet për tensione në veri të Kosovës, MPB: Gati për çdo situatë

Debat i Berisha-Thaçi për kufijtë, Presidenti i Kosovës: S'kam çështje personale me asnjë lider në Shqipëri

Irrezikshëm, i keq dhe person që punon në favor të "Serbisë". Kështu e ka cilësuar Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, deputeti i VV-së, Rexhep Selimi. Teksa ka folur për deklaratimet e të parit të shtetit për korrigjimin e kufijsh, deputeti tha se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë. Por, ai "zbulon" se Hashim Thaçi është futur në...

Në faqet 4-5

## KEMP-i, SHPALLEN EMRAT E 311 PERSONAVE QE DO KRYEJNE KONTROLLET MJEKESORE

# ISSH: SI DO TE LLOGARITEN PENSIONET E INVALIDITETIT

Lista e plotë me emrat që duhet të paraqiten para komisionit. Nëse nuk kryeni ekzaminimin, nuk mund të përfitoni. Dokumentet që duhet të dorëzoni për të përfituar pagesën shëndetësore



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqet 10-11

VIZITA NE KOSOVE

Meta në Rugovë: Të rinjtë ta shohin të ardhmen në këto troje, burim i atdhedashurisë

Në faqen 3

TRAFIKU I DROGES

7 kg kanabis drejt Greqisë, në pranga 32-vjeçari në Kakavijë

Në faqen 6

DOSSIER

At Gjon Shllaku, si e mbronte Fishtën: Ai nuk e dorëzoi Shqipërinë, dokumentet

Në faqet 8-9

TRASHEGIMIA KULTURORE

Zbulime Arkeologjike në Shqipëri, tri epoka të ndryshme nga 8000 vite para Krishtit

Në faqen 18

SURPRIZAT



Turistët nga Europa 'pushtojnë' perlinë e Adriatikut, 'Prestige Resort' në Golem

Në faqen 7

Mjekja gastrohepatologe: Cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes, që s'duhen neglizhuar

## Albana Duni: Si të trajtoni refluxin gastro-efozageal

Ylli Merja: Kuroji tensionin e lartë të gjakut me uthullën e mollës

Nga VOLTIZA DURO

Një ndër sëmundjet më të shpeshta të ezofagut është edhe refluxi gastro-efozageal, që lidhet me rikthimin e sekrecioneve të stomakut në ezofag. Nëse kjo sëmundje nuk trajtohet, mund të shkaktojë dëmtim



të mukozës së ezofagut në trajtën e erozive apo ulcerave dhe më rrallë me shfaqjen e kancerit kardio-efozageal. Por përveç kësaj, mund të çojë edhe në laringit kronik, ndryshime të zërit, kollë kronike, kruajtje të zërit, granulomë të kordave...

Suplement

## BAZA USHTARAKE REAGIMET

Ish-shefi i Shtabit të FA: Mundësi që t'i kthehemi lavdisë së avionëve patrullues

# Baza ajrore në Kuçovë, Bazo: NATO ka menduar se tani jemi më të besueshëm

"Aviatorët tanë kanë një përvojë të admirueshme me avionët MIG"

Ish-Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Jeronim Bazo, deklaroi dje në studion e "Report TV" se vendimi i NATO-s për të ngritur një bazë ajrore në ish-aerportin e Kuçovës është një mundësi e mirë për të rihvilluar flotën e avionëve luftarakë shqiptarë, të cilët sot nuk ekzistojnë më. Bazo tha se ajo do të shërbejë si një bazë taktike ajrore nga ku avionët e Aleancës do kryejnë operacione, përgatitje si dhe patrullime të hapësirës ajrore. "Ky është një lajm shumë i mirë dhe ia vlen të përshëndetet. Kjo do të thotë që Shqipëria është një vend partner i NATO-s, ia vlen të besohet dhe më pas jepet ky hap plus sa u takon operacioneve të NATO-s, përgatitjeve, operacioneve të patrullimit policor etj. Është një vullnet i konsoliduar politik për t'u afruar NATO-s më tepër nga sa jemi sot", tha Bazo në këtë intervistë. Sipas tij, "infrastruktura ekzistuese është trashëguar nga regjimi i kaluar, siç është edhe baza e Kuçovës. Udhëheqësit politikë kanë këmbëngulur prej kohësh dhe në këtë kuadër është edhe vizita e fundit e Xhaçkës në Departamentin e Mbrojtjes së SHBA". "Baza e Kuçovës ka qenë prej kohësh kandidat për bazën ajrore të NATO-s dhe ky ishte momenti për t'u bërë realitet. Të mos harrojmë seriozitetin e FA si vend anëtar, NATO ka menduar se tashmë jemi më të besueshëm për të mbajtur mbi shpatulla edhe këtë përgjegjësi, për ngritjen e kësaj baze ajrore. Në kuptimin që realizim detyra të këtij niveli, mbështetje, për furnizim, ulje, patrullim ajror etj. Kur bëhet fjalë për jetëgjatësinë e një baze, bëhet fjalë për jetëgjatësinë e Aleancës. Shpresojmë që kjo aleancë do të vazhdojë si organizata më e suksesshme e historisë moderne botërore", tha ish-shefi i shtabit të përgjithshëm të FA. Ai theksoi se, "ky është një investim serioz dhe premisë që do t'u



Ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Jeronim Bazo



### VENDIMI I NATO

Kryeministri Edi Rama në një status në "Facebook" ka njoftuar se Aleanca Atlantike e Veriut, NATO, do të ndërtojë në Shqipëri një bazë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Rama shkroi të shtunën se ky është një lajm shumë i mirë për Shqipërinë. Kryeministri Rama tha se baza ajrore do të ndërtohet në Kuçovë dhe se investimi do të jetë rreth 50 milionë euro.

## Mediat amerikane: NATO modernizon arsenalin mbrojtës të Shqipërisë

Mediat më prestigjioze amerikane, "Washington Post", "ABC News" dhe "Associated Press" i kanë bërë jehonë investimit prej 50 milionë eurosh që NATO-ja ka vendosur të bëjë në bazën ajrore ushtarake të Kuçovës, në Shqipëri dhe synimit të qeverisë për të vazhduar më tej me modernizimin e arsenalit mbrojtës të vendit. "Washington Post" i ka dedikuar një artikull bazës ajrore që pritet të ndërtohet. "Baza ajrore ka qenë atje për dekada të tëra. Baza do t'i shërbejë Shqipërisë dhe gjithashtu do të jemi gjithnjë e më operacionet e furnizimit nga ajri të NATO-s, mbështetjen e logjistikës, policinë ajrore, stërvitjen dhe stërvitjet. Kryeministri tha



gjithashtu se zyrtarët po diskutojnë me Shtetet e Bashkuara mbi modernizimin e mëtejshëm të kapaciteteve ajrore shqiptare", shkruhet në artikullin e "Washington Post". Kryeministri i Shqipërisë deklaroi se NATO-ja ka vendosur të ndërtojë një bazë ajrore në vend. Kryemi-

nistri Edi Rama shkruante të shtunën në profilin e tij në "Facebook" se "Këshilli i Atlantikut të Veriut i NATO-s, institucioni kryesor politik vendimmarrës, ka vendosur të investojë 50 milionë euro (58 milionë dollarë) për të modernizuar bazën ajrore në Kuçovë", 80 kilometra në jug

të kryeqytetit Tiranë. Kjo bazë ajrore ka qenë këtu prej dekadash. Kjo bazë do t'i shërbejë Shqipërisë si dhe do të mbështesë operacionet ajrore të NATO-s për furnizim, mbështetje logjistike, mbikëqyrje ajrore, trajnime dhe ushtrime. Kryeministri tha gjithashtu se zyrtarët po diskutojnë me SHBA-të për të "modernizuar edhe më tej kapacitetet ajrore të Shqipërisë". Shqipëria u bë pjesë e NATO-s në vitin 2009 dhe është ende duke zëvendësuar arsenalin e saj të vjetruar. Ky vend ka dalje në detin Adriatik dhe Jon, si dhe ndodhet në veriperëndim të Greqisë.

shërbejë Forcave Ajrore. Do kthehet në një bazë serioze, e cila do jetë një bazë e mirë trajnime, furnizimi, policimi ajror. Do të jemi gjithnjë e më tepër me Forca Ajrore më të përgatitura, të barabarta dhe të padallueshme nga ato të NATO-s. Aviatorët tanë kanë një përvojë të admirueshme sa u takon avionëve luftarakë, MIG-ve. Kjo bazë mund të krijojë mundësi që ne t'i rikthehemi lavdisë së avionëve

patrullues, ta bëjmë policimin ajror me avionët tanë. Afyon vërtetë benefite kjo bazë ajrore", u shpreh Jeronim Bazo, ish-shefi i Shtabit të FA. I pyetur për arsyet strategjike të këtij vendimi nga ana e NATO-s, Bazo tha se baza e Kuçovës ndodhet në një pozicion të favorshëm strategjik, në qendër të Shqipërisë dhe e aksesueshme nga të gjitha anët. "Unë do t'i vija vetëm pluset kësisaj. Kuçova është

në një pozicion të favorshëm, në qendër të Shqipërisë, e aksesueshme si nga veriu, lindja, perëndimi dhe jugu. Erdhi momenti që u mbushën të gjithë faktorët dhe u mor ky vendim. Në të gjithë kuadrin e benefiteve, të jesh një vend me bazë ajrore të NATO-s, direkt krijon edhe siguri. Patrullimi ajror që bën NATO për hapësirën ajrore të vetën, mbulohet në mënyra të ndryshme. Sot

na e bëjnë aleatët, se s'kemi avionë. Herë bëhet nga Greqia dhe Italia. Kjo bazë do shërbejë për nisjen dhe uljen e avionëve për të bërë policimin ajror, çka do të thotë siguri e situar, platforme e mirë për të rihvilluar avionët sërish në Shqipëri. Në bazë do ketë një personel miks, do ketë edhe ushtarake shqiptarë për ruajtjen si dhe në vendimmarrjen e saj", u shpreh Bazo.



**Rama nxjerr videon: Forcat e Armatosura, në gatishmëri për çdo situatë emergjente**

Pasi dha dje lajmin se në Shqipëri, konkretisht në Kuçovë, do të ndërtohet baza e parë ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, kryeministri Edi Rama ndan me ndjekësit në "Facebook" një ditë nga stërvitja e Forcave të Armatosura. Përmes një postimi në rrjetin social, Rama tregon se si Forcat e Armatosura vijnë punën në terren, për të qenë të gatshëm në çdo situatë në kuder të sezonit turistik, pavarësisht temperaturave të larta. "Mirëmëngjesi dhe me këtë videoinformacion mbi gatishmërinë e rritur të Forcave të Armatosura në këto ditë të nxehta për të përballuar çdo situatë emergjente dhe për të kontribuar në sigurimin e një sezoni turistik të mbarë, ju uroj një të diel të qetë", shkroi dje Rama.





**M**inistri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj pati një takim me strukturat drejtuese të Drejtorisë Vendore të Policisë në Vlorë, ku në fokus janë masat policore dhe trajtimi i problematikës që lidhet me mbarrëvajtjen e sezonit veror. Ministria njofton se në takim u diskutua edhe mbi masat për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe mbajtjen nën kontroll të elementëve me precedentë penalë. Gjithashtu, Xhafaj ka dëgjuar edhe ecurinë e hetimeve për goditjen e grupeve kriminale në këtë qark, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Ministri Xhafaj bëri inspektim edhe në Portin e Vlorës, ku këto ditë ka fluks udhëtarësh për shkak të pushimeve verore. Policia Kufitare edhe në Vlorë

**Ministri i Brendshëm takon strukturat drejtuese në Vlorë**

**Xhafaj: Të mbahen nën kontroll elementet me precedentë penalë**



pritet të aplikojë lexuesit e lëvizshëm të pasaportave, për të shmangur radhët në hyrjet e daljet në port dhe lehtësuar lëvizjen e qytetarëve. Ministri kërkoi nga autoritetet policore në port një shërbim më të mirë dhe komunikim më etik, marrë sh-

të mbarrëvajtjes së sezonit turistik 2018, në përputhje me prioritetet e Ministrisë së Brendshme, për t'u garantuar qytetarëve një shërbim policor në përputhje me standardet e kërkuara, specialistë të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) kanë ndërmarrë një fushatë sensibilizuese në pikat kufitare. Ata ishin në Pikën e Kalimit Kufitar në Portin e Vlorës, për të folur me qytetarë e pushues dhe për t'i njohur me shërbimin, si dhe shpërndanë kartvizita me numrin pa pagesë 0800 90 90, ku çdokush mund të denoncojë shkeljet e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Presidenti në Bjeshkët e Rugovës: Kjo trevë, burim i pashtershëm i atdhedashurisë dhe i sakrificave për kombin

**Meta: Uroj që Kosova të përfitojë liberalizimin e vizave**

*Mesazhi i kreut të shtetit: Të rinjtë duhet ta shohin të ardhmen e tyre në këto troje*

Darina Tanushi

**P**residenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi djë Rugovën e Pejës, ku u mikprit nga kryetari i komunës, Gazmend Muhaxheri, si dhe mori pjesë duke përshëndetur veprimtarinë tradicionale popullore, kulturore e artistike, "Lojërat tradicionale të Rugovës" të mbajtur në fshatin Stankaj, me praninë e mijëra bashkatdhetarëve nga të gjitha trojet shqiptare. Presidenti Meta e nisi ditën në Bjeshkët e Rugovës, duke përshkuar me ecje për rreth dy orë së bashku me kampionin e peshëngritjes, Erkan Qerimaj, rrugën që lidh Bogën me Shkrelin. Me rastin e kësaj vizite, Bashkësia Territoriale Rugovë dhe Këshilli Organizativ "Rugova 2018" i dha Presidentit të Republikës me anë të kryetarit të saj, zotit Vesel Nikçi, titullin "Mirënjohje" me motivacionin "Për kujdesin dhe angazhimin e vazhdueshëm në afirmimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, djë në Rugovë

etnorajonit Rugovë". Duke vlerësuar bukuritë e rralla të natyrës shqiptare, Presidenti Meta vuri në dukje se: "Shpreh kënaqësinë më të madhe që ndodhem sot në mes të këtyre bjeshkëve të mrekullueshme të Rugovës, të cilat janë vërtet mjaft frymëzuese! Janë vërtet mjaft oksigjenuese. Janë

vërtet një burim i pashtershëm i atdhedashurisë dhe i sakrificave për kombin e për çështjen kombëtare". "Është një kënaqësi e veçantë që jam në Rugovën e Ibrahim Rugovës e të gjithë shqiptarëve! Sikurse ishte kënaqësi të shëtitja sot nga Boga në Shkrelin e Azem Shkrelit e në mjaft vise të

tjera, duke shijuar këto bukuri përrallore, që kanë nevojë të vizitohen edhe më shpesh. I ftoj shqiptarët e Rugovës e Kosovës që në këtë periudhë të vizitojnë Shqipërinë për më shumë det dhe nga Shqipëria të vijmë këtu në mal, në këto bjeshkë të mrekullueshme. Kështu turizmi do të zhvillohet në

**ECJA**

Presidenti Meta e nisi ditën në Bjeshkët e Rugovës, duke përshkuar me ecje për rreth dy orë së bashku me kampionin e peshëngritjes, Erkan Qerimaj, rrugën që lidh Bogën me Shkrelin. "Së bashku me kampionin e peshëngritjes, Erkan Qerimaj përshkuar sot me ecje për rreth 2 orë në Bjeshkët e Rugovës, rrugën mahnitëse nga Boga në Shkrel e kthim në Bogë. Natyra fantastike e kësaj treve përrallore të legjendave, zanave, miteve e heronjve të kombit, na e lehtësoi sfidën e vështirë", shkroi Meta në "FB".

mënyrë edukojmë edhe brezat e rinj me dashurinë për këtë vend e për këto troje dhe forcojmë identitetin kombëtar dhe kulturor. Përgëzimet më të mira për të gjithë ju! Për kryetarin, zotin Muhaxheri, të cilin i uroj një mandat të suksesshëm dhe njëkohësisht edhe për ansamblin 'Rugova' dhe për të gjithë ata që marrin pjesë në këtë veprimtari të mrekullueshme!", tha më tej në fjalën përshëndetëse, Presidenti Meta. "Uroj që Kosova shumë shpejt do të përfitojë liberalizimin e vizave dhe në këtë mënyrë, të vazhdojë rrugëtimin drejt përparimit, në interes të të gjithë qytetarëve të saj, në mënyrë të veçantë në interes të të rinjve, të cilët duhet ta shohin të ardhmen e tyre në këto troje, në këto alpe. Sepse ne e dimë shumë mirë që as Austria, dhe as Zvicra nuk i kanë alpet më të bukura se ne!", theksoi Meta. "Por - nënvizoi ai - ne duhet të punojmë më shumë që të rinjtë tanë të punojnë këtu dhe këtu bukur, që natyra u ka dhënë këtyre trojeve, me punën e edukimin e tyre, ta kthejnë në mirëqenie për të gjithë".

**NJOFTIM**

Ne date 08.08.2018 ne orën 16.00 ne zyren e permbaresut gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perde, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shirjen e pasurise se paluajtshme te llojit **"Apartment"** me sip.68 m2, me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5. Ure Vajguore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njembdhjete mije e dyqind) lekë.

**Njoftim për shitje me ankand**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezuesit K.S të ndodhur në Panahora Malikastër. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:  
 ■ Pasuria "Are" nr. 206/48 vol. 5 fq.31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869, me cmim prej 1.500.000 lekë  
 ■ Pasuria "Are" nr. 206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmim prej 100.000 lekë  
 ■ Pasuria "me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me cmim në masën 520.832 lekë  
 Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet dt 16.08.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra 5. Kont tel. 672082543, e-mail ilir\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dt. 08.08.2018 ora 16:00  
 Përfundon Ankandi i Parë për pasurinë:  
 - Pasuria "Trullai-Ndërrësë" me sip.529.25 m2, me adresë Sallimone, Durrës. Me cmim 40 000 Euro  
 - Pasuria "Arë" me sip.3750 m2, me adresë Hardhishtë, Durrës. Me cmim 22 400 Euro  
 Ankandi Zhvillohet në zyren e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria ),Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

# KUFIRI KOSOVE-SERBI REAGIMET

Paralajmërimet për tensione në veri të Kosovës, MPB: Gati për çdo situatë


## Korrigjim kufijsh? Selimi: Thaçi ka nënshkruar marrëveshjen me Serbinë

Mediat serbe: Ushtria jonë, e gatshme në të gjithë territorin

I rrezikshëm, i keq dhe person që punon në favor të Serbisë". Kështu e ka cilësuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, deputeti i VV-së, Rexhep Selimi. Teksa ka folur për deklaratimet e të parit të shtetit për korrigjim kufijsh, deputeti tha se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë. Por, ai "zbulon" se Hashim Thaçi është futur në një skenar të rrezikshëm, që përmes "mjegullës" të "shesë" një marrëveshje shumë të dëmshme për ndarjen etnike në Kosovë, në mes tij dhe Aleksandër Vuçiç, të cilën sipas tij, po e mbajnë të fshehtë për opinionin. Ai paralajmëron veprime konkrete nga Lëvizja 'Vetëvendosje', për ndaljen e këtij skenari të Hashim Thaçit. "Mjegulla e njeriut më të rrezikshëm në Kosovë" - paralajmërimi për marrëveshjen sekrete Thaçi-Vuçiç, shkruan Insajder. Deputeti i Lëvizjes 'Vetëvendosje', Rexhep Selimi i ka komentuar deklaratimet e presidentit Hashim Thaçi, i cili ka thënë se Lugina e Preshevës do të bashkohet me Kosovën. Për Selimin, nuk bëhet fjalë për bashkëngjitjen e kësaj pjese me Kosovën, por "një skenar të rrezikshëm për shitjen e një marrëveshjeje të rrezikshme në mes dy personave: Hashim Thaçit dhe Aleksandër Vuçiç". "Thaçi në këto deklarata po tregon edhe njëherë aftësinë e tij për ta mjegulluar gjithçka që ka të bëjë me raportin mes Kosovës dhe Serbisë. Në fakt, nuk bëhet fjalë në këtë moment as për këmbim territore, as për ndryshim kufijsh. Në këtë rast bëhet fjalë për marrëveshjen shumë të rëndë dhe të keqe që tashmë Thaçi e ka nënshkruar me Serbinë dhe krejt çka po ndodh tani është për ta mbuluar këtë marrëveshje. Lojërat e tilla vazhdojnë të mbesin lojëra të rrezikshme nga një person i rrezikshëm, që quhet Hashim Thaçi. Kemi paralajmëruar se kur bëhet fjalë për Thaçin, ai nuk është politikan i keq, por edhe një politikan i rrezikshëm. Ju kemi paralajmëruar për një epilog të tillë të Thaçit dhe Vuçiçit", tha ai. Situata në veri të Kosovës ka ngritur në këmbë të gjithë institucionet vendore. Pas lajmeve që qarkulluan mbi tezat se çfarë mund të ndodhin në Mitrovicë, zv.ministri i Punëve të Brendshme, Abdullselami Shkodra, ka qenë në terren duke parë nga afër situatën, e cila sipas tij është paraqitur e qetë. "Informacione të tilla kanë qarkulluar, mirëpo institucionet e vendit kanë marrë me seriozitet çdo informacion që ka ardhur edhe nga pjesa veriore, mirëpo deri tani nuk kemi asnjë lloj veprimi që do të binte



Deputeti i VV-së, Rexhep Selimi



### MEDIAT SERBE

"Këshilli i Sigurisë Kombëtare të Serbisë u mbledh të shtunën paradite për gati dy orë, kurse konsultimet erdhën për shkak të zhvillimeve të fundit në Kosovë dhe informatave nga shërbimet e zbulimit, sipas të cilave shqiptarët po planifikonin të ndërhyjnë në veri të Kosovës, si pasojë e paralajmërimeve të rreme se serbët në mënyrë të njëanshme do të shpallnin formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe".

### REXHEP SELIMI

"Në fakt, nuk bëhet fjalë në këtë moment as për këmbim territore, as për ndryshim kufijsh. Në këtë rast bëhet fjalë për marrëveshjen shumë të rëndë dhe të keqe, që tashmë Thaçi e ka nënshkruar me Serbinë dhe gjithçka po ndodh tani është për ta mbuluar këtë marrëveshje", tha Selimi.

### ABDULSELAMI SHKODRA

"Institucionet e vendit kanë marrë me seriozitet çdo informacion që ka ardhur edhe nga pjesa veriore, mirëpo deri tani nuk kemi asnjë lloj veprimi që do të binte ndesh me legjislacionin në fuqi. Mund të themi se situata nuk është e ndryshueshme, por është mjaft e qëndrueshme", ka thënë Shkodra.

ndesh me legjislacionin në fuqi. Mund të themi se situata nuk është e ndryshueshme, por është mjaft stabile", ka thënë Shkodra për televizionin publik. Ai shprehet se institucionet e sigurisë kanë qenë të gatshme t'i përgjigjen çdo situatë që mund të ndodhë në veri. Kryeministri Ramush Haradinaj kishte takuar Këshillin e Sigurisë, ku kishte bërë të ditur se nuk do të lejon veprime që prishin rendin kushtetues. "Informacionet që kanë qarkulluar nuk mund të themi se nuk

kanë qenë serioze, por situata nuk ka ndryshuar dhe vazhdon të jetë e njëjta", shtoi Shkodra. Kujtojmë se dje në mbrëmje qarkulloi edhe lajmi se forca të KFOR-it kishin marrë nën kontroll Liqenin e Ujmanit, por këta zyrtarë sqaruan se lëvizjet e trupave të tyre po bëhen në kuadër të ushtrimit operativ të paralajmëruar. Ndërkaq, nga ana tjetër mediat serbe raportojnë se ushtria e Serbisë ka ngritur gatishmërinë luftarake në të gjithë territorin e saj, për shkak të të ashtuquajturave, tensione në Kosovë.

### Ambasadori amerikan: SHBA-të s'kanë ndryshuar qëndrim për Kosovën

## Tensione në veri të Kosovës zv.drejtori i policisë: Sot, një ditë e zakonshme në Mitrovicë

Kyle Scott, ambasadori amerikan në Serbi, deklaroi se Uashingtoni është gati të ndihmojë Kosovën dhe Serbinë për arritjen e një marrëveshjeje. Ai tha se nuk pret që administrata e presidentit Donald Trump të ndryshojë në mënyrë drastike qëndrimin e Uashingtonit lidhur me statusin e Kosovës. Në një intervistë për radio "Beograd", Scott theksoi se interesat amerikane nuk ndryshojnë nga presidenti në president dhe se qëllimi i SHBA-ve mbetet pajja dhe stabiliteti në Ballkan, si dhe transformimi drejt demokracisë dhe forcimi i marrëdhënieve ekonomike. Sipas tij, Shtetet e Bashkuara vlerësojnë se pa normalizimin e mar-



turave, tensione në Kosovë. Pas takimit të së shtunës të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Serbisë, gazeta serbe "Novosti" shkruan se organet e sigurisë kanë rritur aktivitetet e tyre për të parandaluar "planet e autoriteteve në Prishtinë që të shkaktojnë trazira në Kosovë, por edhe veprimtarinë e qarqeve të caktuara në Serbi, të cilat me lajme të rreme po shkaktojnë shqetësim në mesin e popullatës serbe në

trazira në veri të Kosovës, situata në Mitrovicë paraqitet e qetë. Ndërkaq, zëdhënësi i policisë në Mitrovicë, Avni Zahiti ka bërë me dije për "Kosova-Press" se situata në jug të Mitrovicës është e qetë. Edhe zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për Rajonin e Veriut, Besim Hoti pohoi të njëjtën gjë. "Është një ditë e zakonshme, pa ndonjë aktivitet që mund të kërcënojë sigurinë e përgjithshme ose rendin publik", ka thënë Hoti. Ndërkohë, njësitet elitare të Policisë së Kosovës janë grumbulluar në bazën "Belvedere" të Mitrovicës, por siç mëson "Kosova-Press", prania e tyre ka të bëjë me një ushtrim të planifikuar më herët.

verit të Kosovës dhe në jug të Ibrit", shkruan "Telegraf". Në të njëjtën kohë, duke cituar "burime të mirinformuara", gazeta serbe shkruan se "kreu shtetëror serb po shqyrton masat që do të merren për shkak të shkeljes së Marrëveshjes së Brukselit dhe refuzimit tashmë prej pesë vitesh të shqiptarëve për të obligimin për të krijuar Asociacionin e Komunave me shumicë serbe". Gazeta shkruan se, "Këshilli i Sig-

urisë Kombëtare të Serbisë u mbledh të shtunën paradite për gati dy orë, kurse konsultimet erdhën për shkak të zhvillimeve të fundit në Kosovë, dhe informatave nga shërbimet e zbulimit, sipas të cilave shqiptarët po planifikonin të ndërhyjnë në veri të Kosovës, si pasojë e paralajmërimeve të rreme se serbët në mënyrë të njëanshme do të shpallnin formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe".

Shoqëria përparimtare "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., ofron shpalljen për shpalljen në anandit të pasurive të palajqishme. "Njësi" me sipërfaqe 62 m2, me vendndodhje Lagja "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në proninë të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27-4-2, Zona Kadastrale 85/1, Vullmi 34, Faqe 193, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i anandit është 11,577,384 Lekë. Anandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 08.08.2018. Anandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përparimtare "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com





Debati në distancë me Berishën për kufirin, sqaron Presidenti i Kosovës

# Thaçi: 'Skam çështje personale me asnjë lider në Shqipëri apo në Kosovë'

"Presheva, Bujanoci dhe Medvegja duhet t'i kthehen Kosovës"

Debatet në distancë për kufirin e Kosovës po vijojnë të tilla. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka sqaruar edhe një herë idenë për korriginimin e kufijve, në kuadër të fazës së fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Thaçi ka theksuar se "korrigjimi i kufijve" nuk nënkupton ndarje dhe as shkëmbim të territoreve. Në një intervistë për "Kosovapress", Thaçi insiston se Kosova duhet të adresojë kërkesën e Luginës së Preshevës në dialogun me Serbinë. Thotë se në dy dekadat e fundit asnjëherë nuk ka dalë kundër intereseve të qytetarëve të Kosovës dhe SHBA-ve. Presidenti Thaçi pranon se ka dallime ndërmjet liderëve të Shqipërisë dhe Kosovës sa i takon dialogun, por shprehet se statusi i fundit në "Facebook" nuk i është drejtuar ish-kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

## Vasili reagon ndaj Thaçit: Kufijtë janë mirë, na duhet vetëm që t'i mbrojmë siç duhet

Kreu i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili, ka reaguuar pas debatit të krijuar ditën e djeshme me Presidentin Thaçi dhe ish-kryeministrit Berisha për çështjen e kufijve. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", deputeti i LSI i ka dhënë një përgjigje presidentit Thaçi në lidhje me nismën e tij për ndryshimin e kufijve të Kosovës dhe për sulmin e bërë ndaj ish-kryeministrit Sali Berisha. "Kufijtë janë në rregull, ndërsa ekonomia jo, ndërsa 'hallet' e vetes të mos i bëjmë të shqiptarëve", shkruan Vasili në "Facebook" si përgjigje ndaj sulmit të djeshëm të Thaçit. "Luftëra të mëdha kanë përcaktuar fituesit dhe humbësit, kanë përcaktuar edhe kufijtë e fituar, kanë përcaktuar edhe shqiptarët si fitues. Dhe fituesi duhet të sillet si fitues e kundërta është faj. Ekonomia nuk është në rregull as në Shqipëri dhe as në Kosovë. Është në krizë ekonomia. Është i madh korupsioni. Pastrohen edhe para të pista shumë bile. Shqiptarët këndej dhe aty kufirit presin ekonomi shumë herë më të mirë dhe më të fortë. Kush i lë shqiptarët të varfër është armik i tyre. Sa për kufijtë, ata mirë janë, na duhet vetëm që t'i mbrojmë si duhet. 'Hallet' e vetes të mos i bëjmë halle të shqiptarëve", u shpreh dje Vasili.



**Në javët e fundit keni përdorur termin "korriginim i kufijve". Kjo nga përfaqësues institucionale dhe politike është përkthyer si shkëmbim i territoreve, megjë Serbia tradicionalisht kërkon territor nga Kosova. A mund të na tregoni saktë çfarë mendoni me korriginim të kufijve?**

Korriginimi i kufijve nuk është term i shpikur nga

**MYSLYM MURRIZI**  
Deputeti i PD-së, Myslym Murrizi u shpreh dje se deklaratat e presidentit Thaçi janë për të ardhur keq. Deputeti Murrizi thotë: "Firma e Thaçit për shiften e Kosovës tek Serbia nuk është bast, por shkak për luftë. Kur një president i një shteti, qoftë ky edhe i Kosovës, flet si shtëpiakët e dëshpëruara dhe quan të mirëqenë 'tregimin' e të dashurës së Arkanit është për të ardhur keq", tha ai.

unë, por shumë shtete në botë e kanë përdorur si mjet për të tejkaluar hasmëritë, për të zgjidhur problemet, për të krijuar paqe afatgjate. Këto ditë e kam përsëritur shpesh që korriginimi i kufijve nuk nënkupton ndarje, nuk nënkupton shkëmbim të territorit. Po e them edhe ndryshe, korriginimi i kufijve nuk do të sjellë ndarje të Kosovës. Këtë duhet ta kenë të qartë të gjithë. Gjatë gjithë këtyre vjetëve që kur kemi në dialog, institucionet e Kosovës janë kritikuar pse çështja e Luginës së Preshevës nuk po diskutohet në dialogun me Serbinë. Tashme të njëjtit njerëz kërkojnë që t'i mbyllim sytë përballë kërkesës legjitime të tyre për t'iu bashkangjitur Kosovës. Prandaj, kërkesa jonë është që Kosovës t'i kthehet Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, megjë Serbia nuk ka arritur që t'u garantojë atyre të drejtën, të cilat Kosova u garantojnë serbëve në Kosovë.

**Për të qenë më i qartë, ju mendoni se Kosova nuk e jep verin në shkëmbim të Preshevës?**

Kosova nuk ka hyrë në këtë dialog për të humbur, as për të dhënë. Kosova ka hyrë në këtë dialog për të arritur marrëveshje paqësore në përputhje me interesat shtetërore. Kosova përballë Serbisë gjithmonë ka dalë fituese, sepse kemi qenë

të bashkuar në të drejtën tonë për liri, pavarësi dhe kemi pasur në vazhdimësi përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Prandaj, i gjithë spektri politik, shoqëria civile, duhet të jemi të bashkuar për t'ia sjellë Kosovës fitoren e radhës, atë të anëtarësimit në BE, NATO dhe OKB.

**Kundër korriginimit të kufijve kanë dalë partnerët qeverisës dhe krejt opozita. Madje, edhe miq të Kosovës. A dini diçka që të tjerët nuk dinë? A e keni mbështetjen amerikane për idenë e korriginimit të kufijve?**

Këtu ka një keqkuptim të madh, i cili duhet sqaruar. Unë kam propozuar korriginimin e kufijve si opsion të mundshëm për arritjen e marrëveshjes paqësore përfundimtare. Ndarja dhe shkëmbimi i territoreve janë opsione të papranueshme edhe për mua. Në dy dekadat e fundit, në të gjitha proceset politike, Kosova ka dalë fitimtare pikërisht se ka besuar në SHBA-të, edhe atëherë kur disa kanë pasur dyshime apo kanë qenë skeptikë. Gjithmonë kemi qenë bashkë me Amerikën. Edhe në fazën e fundit të dialogut jemi bashkë. Ne nuk do të befasojmë partnerin tonë strategjik, i cili ka meritë për lirinë edhe pavarësinë e Kosovës. SHBA dhe BE janë fuqishëm në mbështetje të

arritjes së marrëveshjes dhe janë të koordinuara me tyre.

**Ndërkohë, për qëndrimin tuaj jeni kritikuar ashpër nga ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha. Menjëherë i jeni përgjigjur me kundërrakuzat të rënda. Pse reaguat ndaj tij?**

Ky është vetëm interpretim i mediave dhe asgjë më shumë. Së pari, mendoj që z. Berisha ka dhënë mendimin e vet për atë se çfarë mendon për zhvillimet në Preshevë, Bujanoci dhe Medvegje. Unë e respektoj mendimin e tij, por mendoj se nuk mjafton vetëm respektimi i mendimeve të njeriut për shqiptarët atje, sepse Serbia ka dështuar ta bëjë këtë në vazhdimësi. Unë konsideroj që ne kemi një mundësi të vogël që të provojmë bashkimin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes me Kosovën. Fundja, kjo është ajo çfarë shqiptarët dhe përfaqësuesit politikë të Luginës janë duke kërkuar nga institucionet e Kosovës. Unë jam i prirë të dëgjoj më shumë këta të fundit se sa këdo tjetër. Por, më vjen keq që disa media janë bërë mjeshtër të shtrembërimit të së vërtetës. Është lehtë të parashikohen tituj të tillë bombastikë edhe pas kësaj interviste. Por, interesi shtetëror dhe nacional nuk vendoset nga lajmet e rreme, por vetëm me vendime institucionale dhe të përgjegjshme. Unë nuk kam çështje të hapura personale me asnjë lider në Shqipëri apo në Kosovë. Mirëpo sigurisht që kemi dallime kur është në pyetje dialogu me Serbinë. Pavarësisht kësaj, unë besoj në drejtësinë historike që Presheva, Bujanoci dhe Medvegja duhet t'i bashkohet Kosovës.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### PROCEDURE PROKURIMI

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 17.500.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 0424194111(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëveshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përskrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 06 Shtator 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Drejtuasi i mjetit, Skerdi Hasani dyshohet për trafikim të narkotikëve

## KAKAVIJË

Goditet një tjetër rast i trafikimit të lëndëve narkotike. Policia Kufitare sekuestroi ditën e djeshme rreth 7 kilogramë kanabis sativa, që kishin si destinacion Greqinë. Droga ishte fshehur në gomën rezervë të një automjeti tip "Toyota Rav". Sipas burimeve, mësohet se në brendësi të gomës rezervë kishte 14 pako me lëndë narkotike. Në pranga ka rënë drejtuesi i mjetit, i cili mësohet se është 32-vjeçari Skerdi Hasani, banues në Memaliaj. I riu akuzohet për veprën penale të trafikimit të narkotikëve.

## NGJARJA

Në vijim të masave të marra nga ana e Policisë Kufitare për rritjen e forcës parandaluese, evidentuese dhe goditëse ndaj veprimtarisë kriminale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, qenieve njerëzore, si dhe mallrave kontrabandë, shërbimet e Policisë Kufitare në bashkëpunim me shërbimet doganore kanë evidentuar dhe goditur një tentativë për trafik të lëndëve narkotike. "Kjo veprimtari mund të zhvillohet duke përfutur edhe nga fluksi në rritje i turistëve dhe shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit dhe vijmë për pushime në Shqipëri", thuhet në njoftimin e policisë. Shërbimet e Policisë Kufitare kanë përzgjedhur për kontroll më të detajuar në vijë të dytë automjetin "Toyota Rav", që drejtohej nga shtetasi Skerdi Hasani, 32 vjeç, banues në Memaliaj, i cili udhëtonte për në Greqi. Nga kontrolli i detajuar i kryer nga punonjësit e Policisë

# Tentoi të trafikonte drogë drejt Greqisë, arrestohet 32-vjeçari në Kakavijë

Policia zbulon 7 kg kanabis në gomën e "Toyota"-s



Droga e sekuestruar në Kakavijë

Kufitare në vijën e dytë ka rezultuar se në gomën rezervë kishte të fshehura disa pako të mbështjella me letër natriban, të cilat dyshohet se janë të mbushura me lëndë narkotike kanabis sativa. Menjëherë është njoftu-

ar grupi hetimor, ku kanë mbërritur Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjrokastër. Nga veprimet e kryera nga grupi hetimor rezultoi se në brendësi të gomës rezervë kishte 14

7

## KG KANABIS

Nga veprimet e kryera nga grupi hetimor rezultoi se në brendësi të gomës rezervë kishte 14 pako me lëndë narkotike kanabis sativa, me peshë rreth 7 kilogramë gjithsej, e cila është sekuestruar në cilësinë e provës materiale bashkë me automjetin.

## KOKAINË NË SARANDË

Dy të rinj kanë rënë në prangat e policisë, pasi u kapën me një sasi droge. Bëhet fjalë për shtetasit Fabion G., 18 vjeç dhe Klaus Hoxha, 19 vjeç, nga Fieri, të cilët u kapën në një sasi prej 0.25 gr kokainë dhe 24 gr kanabis. Në cilësinë e provës materiale u janë sekuestruar po ashtu edhe 3555 euro, 54 mijë lekë të reja, një automjet dhe dy aparate celularë. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve".

pako me lëndë narkotike kanabis sativa, me peshë rreth 7 kilogramë gjithsej, e cila është sekuestruar në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin. Drejtuesi i mjetit është shoqëruar në ambientet e Drejtorisë

Vendore të Policisë Gjrokastër, ku në përfundim të veprimeve të kryera nga specialistët për hetimin e narkotikëve u bë arrestimi në flagrancë për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve".

## Policia: Mjeti, jashtë kushteve teknike

### Drejtonte autobusin në gjendje në dehur, arrestohet shoferi në Dibër

Një shofer autobusi në Dibër është vënë në prangat e policisë ditën e djeshme, pasi është kapur i dehur në timon. Në momentin kur është ndaluar nga uniformat blu, shtetasi Enver Koçi, nga Bulqiza drejtonte autobusin me 30 punëtorë (të një firme private). Mësohet se 49-vjeçari, 32 vjeç, banues në Memaliaj, i cili udhëtonte për në Greqi. Nga kontrolli i detajuar i kryer nga punonjësit e Policisë



kushteve teknike dhe i papajisur me leje drejtimi", thuhet në njoftimin e policisë. Në vijim të kontrolleve nga Policia Rrugore në pranga ka rënë edhe shtetasi Kujtim Gjoni, 50 vjeç, banues në Tiranë, pasi drejtonte automjetin furgon në gjendje të dehur në masën 0.88 mg/l. 50-vjeçari drejtonte mjetin jashtë kushteve teknike. Mate-

rialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë Dibër për veprën penale "Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor". Kontrollat do vijojnë në të gjithë qarkun, me qëllimin e vetëm respektimit e rregullave të qarkullimit rrugor, duke kontribuar të gjithë në rritjen e parame-trave të sigurisë së jetës në Greqi.

rialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë Dibër për veprën penale "Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor". Kontrollat do vijojnë në të gjithë qarkun, me qëllimin e vetëm respektimit e rregullave të qarkullimit rrugor, duke kontribuar të gjithë në rritjen e parame-trave të sigurisë së jetës në rrugë.



### Panik në Korçë, dhëndri shkon për të marrë nusen, rrëzohet helikopteri gjatë uljes

KORÇË - Rrëzimi i një helikopteri privat në Korçë ditën e djeshme, për pak sa nuk ka përfunduar në tragjedi. Mësohet se helikopteri ishte kontraktuar për marrjen e një nuseje. Teksa dhëndri po shkonte në Korçë për të marrë nusen, mjeti është rrëzuar. Helikopteri ka bërë ulje emergjente në mes të një blloku me pallate, pranë vendit të quajtur "Kryqëzimi i Ersekës". Në momentin e incidentit në bord ka qenë piloti Altin Lama dhe dhëndri. Ideja e çiftit për të udhëtuar me helikopter ditën e martës shkaktoi panik të madh tek familjarët dhe miqtë e tyre. Shkak dyshohet një manovrim i gabuar i pilotit dhe gjatë uljes helikopteri është përplasur me një pemë. Fatmirësisht nuk ka të lënduar, por pasojë janë shkakuar vetëm dëme materiale të helikopterit. "Më datë 05.08.2018, në afërsi të vendit të quajtur "Kryqëzimi i Ersekës", pranë Unazës në Korçë, si shkak i një manovrimi të gabuar në ulje, është rrëzuar në një shesh pushimi, helikopteri i një shoqërie private me pilot shtetasin A.L. dhe pasagjer shtetasin G.H.. Për pasojë, janë shkakuar vetëm dëme materiale të helikopterit. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë.

## SHKURT

#### Shkrumbohet banesa në Librazhd, dyshohet shkëndijë elektrike

LIBRAZHD - Një zjarr ka rënë gjatë mesnatës së të shtunës në Perrenjas në një banesë duke e djegur plotësisht atë. Mësohet se banesa i përket shtetasit N.Ç., 56 vjeç. Nga zjarri i rënë nuk ka asnjë person të lënduar, ndërsa grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të shkakut të ngjarjes. Nga hetimet paraprake dyshohet se zjarri ka ardhur nga shkëndijë elektrike, pasi edhe nga deklarimet e familjarëve nuk pretendohet se ishte i qëllimshëm.

#### Lëvizte me pistoletë në Vlorë, arrestohet

## adoleshenti

VLORË - Një 17-vjeçar ka përfunduar në prangat e policisë, pasi lëvizte i armatosur. Burime zyrtare nga policia e Vlorës bënë me dije se i riu u kap nga shërbimet policore në lagjen "Pavarësia 2", duke lëvizur me një pistoletë pa leje. Arma e zjarrit u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Prodhim, shitje e armëve luftare dhe municionit".

#### Hidhet nga trampolina, plagoset në Sarandë


## pushuesi polak

SARANDË - Një turist polak, i cili po pushonte në bregdetin shqiptar ka rrezikuar jetën ditën e djeshme pasi u hodh me kokë nga trampolina. I plagosuri është identifikuar si Kamil Thothell, 45 vjeç, nga Polonia, i cili u hodh nga trampolina me kokë dhe humbi vetëdijen. Si pasojë e përplasjes, pësoi çarje të madhe në kokë. Menjëherë ka ndërhyrë roja bregdetare duke e nxjerrë në breg dhe më pas njoftoi ambulancën. Ngjarja ka ndodhur në Plazhin e Ri në Sarandë, ndërsa i plagosuri është transportuar drejt spitalit për ndihmë mjekësore, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

#### Dhunon gruan në sy të fëmijëve, arrestohet 34-vjeçari nga Vlora

VLORË - Dhunë ndaj gruas i ka kushtuar lirimë një 34-vjeçar nga Vlora, i cili ka përfunduar në burg. Burime zyrtare nga policia e Vlorës bënë me dije se Ardian Sh. akuzohet se në banesën e tij, në lagjen "24 Maji", në prani të fëmijëve ka ushtruar dhunë fizike duke i shkakuar dëmtime bashkëshortes së tij, shtetases N.Sh., 32 vjeçe. Materialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Vlorë, për veprën penale "Dhunë në familje, në prani të fëmijëve".






**Turistët norvegjezë, çekë e polakë zgjedhin të argëtohen në një nga perlat e Adriatikut**

# "PRESTIGE RESORT", destinacioni i duhur për pushime të paharrueshme

*Surpriza, lojëra e zbavitje pafund për çdo grupmoshë*



**S**urpriza, lojëra e zbavitje për çdo grupmoshë, në mënyrë që pushimet tuaja të mbeten të paharrueshme! Zgjidhja e vetme, ashtu si në çdo resort të Europës, është "Prestige Resort". Mes tingujve të muzikës dhe argëtimit, pushuesit shijuan mbrëmjen e së shtunës atmosferën festive, e cila prej javësh mbizotëron në këtë resort. Nën ritmet e këngës "Kuqezi je ti", apo edhe "Xhamadani vija-vija" shihen teksa kërcëjnë pushues të shumtë, fëmijë e të rritur. Për të mos u larguar nga motivet kombëtare, në qendër të resortit valëvitet edhe flamuri kuqezi. Teksa argëtohen, pushuesit norvegjezë, çekë e polakë tundin flamurin kuqezi në ritmin e muzikës. "Prestige Resort", një nga perlat e



Adriatikut, është tashmë destinacioni i preferuar për pushuesit vendës e të huaj, norvegjezë, çekë e polakë. Si një ndër pikat turistike më të preferuara në rajon, ky resort luksoz, i ndërtuar me koncepte të

avancuara ofron kombinimin ideal të natyrës dhe arkitekturës moderne, të ndërthurur mes hijeve të pishave gjysmëshekullore e që brenda pak kohësh ka zënë vendin e parë në bregdetin shqiptar. E

ndërkohë që vera nuk ka përfunduar ende dhe gushti pritet të sjellë temperatura ekstremisht të nxehta, "Prestige Resort" është vendi ideal, i cili ofron shërbimin e komoditetin që gjithkush kërkon.



Nën ritmet e këngës "Kuqezi je ti", apo edhe "Xhamadani vija-vija" shihen teksa kërcëjnë pushues të shumtë, fëmijë e të rritur. Për të mos u larguar nga motivet kombëtare, në qendër të resortit valëvitet edhe flamuri kuqezi.

## DOSSIER DOKUMENTET

# At Gjon Shllaku kur mbronte Fishtën: Nuk e dorëzoi Shqipërinë

*Botohet libri me artikujt e studimet e fratit të vrrarë nga regjimi komunist*


**A**t Vitor Demaj, OFM  
At Mirash Marinaj, OFM  
At Gjon Shllaku nuk asht i panjohur për publikun shqiptar. Njihet për veprimtarinë në "Hyllin e Dritës" dhe në Shtypshkronjën Françeskane, ku qe drejtor për disa vjet. E sidomos, për mprehtësinë me të cilën trajtoi shumë çështje kulturore, tue spikatë posaçërisht në publicistikë, filozofi dhe histori.

Nga një shkrim i "Hyllit të Dritës" mësojmë se kishte dërgue për shtyp "Historinë e filozofisë", vepër tejet e randësishme për jetën kulturore të shqiptarëve e cila, në rrethanat e persekutimit komunist, nuk dihet ku mund të ketë përfundue. Fat, që e pësuen edhe shumë shkrime të tjera. Urojme që ndonji ditë të gjindet e të botohet.

Çka spikat ma shumë në gjithë veprën e At Gjon Shllakut, asht gjuha e pasun, fjala e zgjedhur, mprehtësia intelektuale, dashunia për të bukurën, për Absolutin. Natyrisht në shkrimet e tij vendi kryesor i takon trajtimit të hollësishtë të problemeve sociale, politike dhe kulturore, që shtroheshin për zgjidhje në Shqipëri dhe kohës. Formimi dhe edukimi kulturor e intelektual qenë shqetësimi kryesor në shkrimet e të Lumit.

Në këtë vepër të parë të At Gjonit përmbledhëm artikujt e botuem tek Hylli i Dritës, tue përfshi edhe studimin historik "Katholicizmi në Shqipëri e anmiqt e tij para gjykatores së historis". Ky shkrim i përgjegjej një libri të Nikollë Ivanajt, me jehonë të madhe në gazetat e kohës. Përmes një dokumentimi tejet të pasun, At Gjon Shllaku i kallxon N. Ivanajt dhe mbarë botës shqiptare se Kleri katolik dhe bashkëpunëtorët tij, me në krye Luigj Gurakuqin, vepruen kurdoherë për rrejtjen e sovranitetit të vendit tonë. Kleri në përgjithësi dhe françeskanët në veçanti, punuen dhe vepruen si bij të atdheut, dhe jo si rrogëtarë. Rrogëtarë punon për interesa personale, shkon aty, ku paguhet ma mirë, ndërsa biri punon me mish e me shpirt për të mirën e Atmes së vet.

Në kontributin e tij kulturor u shque në veprimtarinë për mbrojtjen e interesave kombëtare, për edukimin e rinisë, për çështjet sociale dhe për paralajmërimin e rrezikut të komunizmit, gjithnjë shumë i damshëm për individin, familjen dhe shoqërinë. Kur e arrestuen, në Itali, ndër sendet e tij personale, i gjetën edhe "Kapitalin" e Marksit. Jo rastësisht, në vitin 1938, sa qe drejtor i "Hyllit të Dritës" botoi shkrimin "Shka asht komunizmi", në të cilin analizoi doktrinën komuniste dhe njiherit vuni në dukje të metat e saj. Ky



studim i mirëfilltë rreth marksizmit mbetë gjithnjë aktual. Shi në këtë shkrim, At Gjon Shllaku pohon se komunizmi u nis si shkencë, por përfundoi si diktaturë, nën drejtimin fanatik të njerëzve të etun për pushtet që, për ta shue këtë etje, nuk ngurruen të flijojnë me miljona njerëz të pafajshëm. Shumë i vlefshëm, ky shkrim, për historinë e filozofisë.

At Gjoni qe edhe drejtor i Shtypshkronjës së famshme françeskane, ku botoi shkrime të çmueshme të kulturës shqiptare. Ndër të tjera, vepra të Fishtës, i cili, si satirik i pashoq që ishte, shpesh krijonte situata nga ma gazmoret. Kallëxonte At Aleks Baqli sesi një herë, mbasi shkoi në shtypshkronjë për me dorëzue një variant të "Gomarit të Babatës" e nuk e gjeti aty drejtorin, i la mbas dëre një letër, ku shkruante: "ta kam lidhë gomarin për dëre".

Veprën e radhitëm këshu:

historija flet këshu dhe publicistikë. Në përmbledhjen publicistike përshimë artikujt kushtue ekonomisë politike, çështjeve shoqnorë dhe filozofike. Nuk mungon artikulli polemik rreth alfabetit të Manastirit e as recensionit për fjalorin e Kolë Kamsit. Ndonëse At Gjon Shllaku nuk qe gjuhëtar, këto shkrime flasin vetë për aftësitë e tij edhe në këtë fushë.

Jeta e At Gjon Shllakut përfundon me martirizim. Qe vu me kohë në shënjestër prej komunistave, të cilët mezi pritshin ditën për ta arrestue e për ta pushkatue.

E pushkatuen me datën 4 mars, ende pa zbardhë drita. Dha jetën si martir i fesë.

Kushdo që do të lexojë mendimet rreth organizimit shoqor, shkrimet filozofike, hulumtimet historike të të lumit At Gjon Shllaku, do të vërejë menjëherë se në to spikasin tri fjalë: "Shqiptari - Frati - Shqipëria". Dhe historia

e Shqipërisë asht dishmitare e këtij trinomi të pandashëm, unjësue për idealet kulturore, shpirtnore dhe atdhetare.

Deri më sot nuk kemi pasë një vepër të plotë, që përmbledh shkrimet e At Gjon Shllakut. Me botimin, për herë të parë të vepër së tij, urojmë që kontributi i dijetarit françeskan të përhapet dhe të njihet në të katër anët e Shqipërisë, mbasi i lumi At Gjon Shllaku na mëson se idealet shpirtnore dhe atdhetare janë shumë të çmueshme, të njëjshme me jetën e atij, që i jeton. Na kujtojnë gjithnjë se Atdheu ndërtohet mbi themelet e botës shpirtnore, siç pohon Frati ynë:

"Veç një kulturë shpirtnore e hapët asht e zoja të lindë një atdhetashtni, me të cillen të çmohen, të rruhen e të lavrohen karakteristikat e ndiesit kombtare, e mund të sht'j me bā flije ta panumërta për të miren e atdheut". E sidomos (na mëson) të mos bijm në kurthën "ku aventurierat e të çmendunt i bijn lodrës e na duertkosisim marrit e tyne..."

### PËRGJIGJA NDAJ IVANAJT

*Historija flet këshu.... Katholicizmi në Shqipëri e anmiqt e tij para gjykatores së historis. Përgjegje z. N. Ivanajt*

"Dhe Ivanaj me xhambasllakun e vet të fort dhe me inteligjencën e tij të rallë ka mundur t'interesojë mbretët e princër, kryeministra e ambasadorë, diplomatë, e partira të ndryshme politike për çështjen shqiptare.... Ivanaj ka disa "lapus" me dashje, ndofta pse sot nuk është çasti të thuhet gjithçka ose pse do të botojë pjesën e dytë. Por ne jemi aq të pjekur politikisht sa t'a vemë gjishtin edhe në plagë, të degjojmë edhe të vërteta të hidhta. Prandë në kujtime historike është e mira të thuhet kurdoherë e terë e vërteta".

("Bashkimi i Kombit", 9-II-1944 fq. 2)

Me këto fjalë, nder sa tjera, organ gjymës - zyrtar i qeveris, Bashkimi i Kombit, i a paraqet publikut shqiptar librin e z. Nikolla Ivanaj "Historija e Shqipërisë së re, vuejtjet e veprimet e mija" të botuem në Tiranë vjetin e kaluem nga Shtypshkroja e Shtetit. Tue kenë pra se na paskemi mbërritun në një pjekuni politike aqë sa t'a vemë gjishtin edhe në plagë, të degjojmë edhe të vërteta të hidhta si e don Bashkimi i Kombit, menduem të ndrçojmë publikun me anën e dokumentave që kemi per

doresh mbi disa ngjarje të historis s'onë kombtare të kohvet të fundit, të cillat ngjarje libri i naltpermendun i z. Nikolla Ivanaj i paraqet në një dritë që nuk ka me i marrun një e mendt as kritikut historik të motivev që do të vijin. Z. Nikolla Ivanaj, në librin e vet, fq. 84-86, shkruen këshu:


"Ishte vala e zgjedhjetve politike per deputet në të parin Parlament të Shqipërisë lirë. Zgjedhjet ishin të lira persa i perkittë Qeverisë. Por mjerisht, shqiptarët ende s'ishin të lirë. Sidomos katolikët, të cillët - mbas urdhnit të Jezuitve: Perinde ac cadaver - pors trupat të dekonish do t'i shtrohen urdhnit të tyne!... Dhe kjo rrethanë, sidomos tue qene katolikët në Shkodër me rrethi, në shumicën e madhe kishte randësi..."

Prandë, si sbatues i këti urdhen, Atë Gjergj Fishta (në muej të Dhëtorit, 1919 në Paris, Place de la Madaleine, në sah. 23, në shoqni me Luigj Gurakuqin, e Lef Nosit) m'tha: "ti qi nuk binde, se i lypet Shqipërisë Mandati i Italiës - je për tu lidhë dhe rrahë me konop të lagët!..." Dhe e vërteta asht se shokët e tij u çuditne ma teper se unë... Gurakuqizme i dizaprovoj me gjithse - prej habijet - nuk e foli asnji fjale... Lef Nosi e kundërshtoj për "dëntimin" tepër të randë... E si dihet mbas një mueji kta me shokë të tjerë, ranë dhe u rruene keq fort... Mirë po në vend që, së paku, njeri i lidhun me konop (në shej të përvujtësisë, ndigjesë e vorfënisë) të tërhiqej, të shmangej për mos me e pa kush ma deri që të jen gjallë - ky zgjidhet për deputet!...

Per me kuptue mirë nëse këto thanjet të Z. Nikolla Ivanajt a kanë vëlërë a jo, ma së pari lezuesi do t'a dijë se zotnija në fjalë asht një antër militant i Maffias masonike. Në kohën e sundimit të Shkodrës prej Nderkombtarëve, zotni N. Ivanaj pat shkue, n'emen të dhëtë shokvet tjerë, të Koloneli De Philipps me lypë auktorizimin e ndimat per çilëjen e një lozhës masonike në Shkodër, shka i kje dhanë prej kolonelit anglez. Kryepeshkvi katolik i Shkodrës Emz. Serreqi, pat bā një protestë të De Philippsit i për ketë punë. Arrsyeja asht se Masoneria e Katholicizmi janë dy anmiqt të papajteshem njëri me tjetrin.

... Ketë mënyrë veprimi, të cilen na e thrrasin dallkaullek e ka ndjekun z. Nikolla sa e sa herë edhe në perpjekje me rreth të Klerit katolik shqiptar, e





Në foto:  
At Gjergj Fishta



Në foto:  
At Gjon Shllaku

sa për tregim për me i a qitun në mend z. Nikollës, po na kandet me i përmendun rasen, kur nder të parat zgjedhje parlamentare të Shqipërisë së lirë i pat ra nder gjuhë per tokë (literalisht në gjuhë e anikë? Në rrugë të madhe!) Kryetarit të Françeskanvet t'atëherëshem, At Pal Dodaj-t, tue e lutë që t'a shtite në listen e kandidatvet e t'i ndimote me dalun deputat. Edhe vjetin e kaluem, pakë javë para se të shtypëte librin e vet, pat ardhun në Shkodër e lypni ndimen e njëj Prelati të Naltë për me u bënë antar i Këshillit të Naltë të Regjencës. Ketë taktikë levdohet vetë z. Nikolla se e ka ndjekun edhe me "Mbretin Nikitza, tue u mundue me rrejtë njeni tjetrin".

... Rreth kësaj kohe pra, ndër sa Kleri katolik çfaqej botnisht para Konferencës së Pagjës krejtë ndryshej se thotë z. N. Ivanaj e se don me thanë artikull-shkruari në Bashkimi i Kombit, atje në Paris disa shqiptarë luejshin disa lojë jo të bukura, të cillat u a kumton Dergata Shqiptare në Konferencën e Pagjës disa miqvet të vet në një letër të gjatë 24 faqesh, kopja e së cillës rruhet n'arhivin t'onë. Prej kësaj letre e tjeravet, të cillat kemi me i botue kur të jetë nevoja, po nxjerrim një copë që ka të bëjë me Vuetjet e Veprimet e z. N. Ivanajt, e prej kah shihet se z. N. Ivanaj me të vërtetë e kishte urë e gurrë Serbin.

Dergata Shqiptare në Paris, e edhe At Gjergj Fishta, si sekretar

i sajë, tue u gjetun perball kercenimit të lakmivët të Jugosllavëve e të Grekëve në njanen anë, e në tjetren perball divergjencës s'interesavet që kishte Italia me Jugosllavin, anuen e lypen ndimen e Italis, por kurr nuk lypen mandatin ase protektoratin e sajë. E prandë edhe "L'Academico Fishta dice di avere fin da quando si trovava a Versailles con la Delegazione del suo Paese, saputo di veder chiaramente la necessità per l'Albania, di vivere sotto la protezione dell'Italia quasi un bastione avanzato per la perenne storica missione della cultura italiana e mediterranea nei Balcani; e ci aggiunge di non aver fatto un mistero di questa sua convinzione" fq. 86.

Z. Nikolla Ivanaj, mbasi mbahet për politikant do të dijë me dallue në fjalorin diplomatik mjes vivere sotto la protezione dell'Italia e sotto il protettorato dell'Italia, si don me ia njeshë ai P. Fishtës ketë shprehjen e mbrame vetem prej mënis e inatit, të frymëzue prej sillavofilijë së vet. Po të kishte lypun Fishta mandatin ase protektoratin e Italis kohen e Kongresit të Pagjës, do t'ia kishte thanë n'intervistë Aldo Brescani-t, por i thotë vetem vivere sotto la protezione dell'Italia, në një kohë kur, ma heret a ma vonë, z. Nikolla Ivanaj hite e delte te Comm. Meloni për t'a sjellun plakën e politikes e ëer nxjerrjen e rrogës jetike së vet.

Se lypëja e ndimës e e

mproftjes s'Italis ka këndë e nevojëshme për shpëtimin e integritetin e tokës Shqiptare, e bājn dishmi dokumentat e ndryshëshem, prej të cillëvevet vetëm një pakicë po biejm, për të perforcue thezen t'onë. Çdo njeri mundet me pa prej studimit të tyne se padit e z. Nikolla Ivanaj kundrejt Dërgatës Shqiptare në Paris pergjithsisht, e kundrejt P. Gjergj Fishtës veçanërisht, si trashitarë italo-filije, janë të pathemelta, rrena aventurjerash ambiciozë e puthadorësh jugosllavë.

Kështu, na po biejm dy letra të dergueme Dr. Turtullit nga Miss Durham, të cillën shpresoj se as z. Nikolla nuk mund t'a padisë për italo-filie a të shitun Italis. Këjo shprehet në të njajten mënyrë si At Gjergj Fishta e misët tjerë të Dërgatës Shqiptare në Paris. Miss Durham - si shihet prej këtyne letravet - nuk e zotnotë mirë frengishten.

Libri i Z. N. Ivanaj është në vetvedi një absurditet, i cilli, kundruet vetem në pikëpamje të kritikës interne, paraqitet si i tillë. Kushdo që ka më të voglin erudicion historik, gyshtë nder fletë të para të këtij libri, mund të shohë se ka të bëjë me një njeri, i cilli krejtë historinë e Shqipërisë së kohëvet të fundit e sjellë rreth vedit, me një guxim më të madh se do të kishte mujtë me bënë Napoleoni për historinë e Francës që prej rrevolucionit deri në 1821.

Si mbas metodës së kritikës historike jemi mundue me u të lexuesin drejt për drejt në për-

pjekje me dokumenta e me e bënë t'a shohë vetë si bijn poshtë pohimet e Z. N. Ivanajt për shka i perket, rreth kësaj perjudhe, veprimet të klerit e t'elementit katolik pergjithsisht e veçanërisht në Shqipëri. Na është dashtun por me u kufizue, për arsye se ky kapitull i interesantshem i historisë së kësokohshme të vendit t'onë ndr'n në vetvedi një brumë mjaft të madh dhanash, kompleksiteti i të cillave nuk mund të parashtrahet me një synthezë të shkurtë.

Nuk na çuditë aspak jehona me tingull sympathije që i u bënë librit të Z. N. Ivanajt, përveç se në Bashkimi i Kombit, edhe nder rivista të reja (shif b.f. Revista Letrare, nr. 4, 5), pse, këto a janë shprehja e kjarhtë e mungesës së njëj kulture të sens historique prej atyne që pretendojn me ndrëcue popullin, ase - shka është më zi - është zberthimi perjudik i mënis së fanatizmit latent që konkretizohet herë mbas here nder forma të ndryshme. Na i vejmë shej kësaj pune, sikurse u kemi vë shej me vemende të madhe, tash tetë muej e tekjet, në shtypin kombtar, peshperitjeve kundrejt elementit katolik, sikur t'ishite ky gjoja perjegjes për tragjedin e 7 Prillit e të shperdorimevet të bame prej Italtjanvet në Shqipëri. Për në kje se vijohet në ket mënyrë me u mendue nderimi ndaj lirin e shtypit, kemi me e ndie vedin të ngushtuem edhe na t'i lamë në njanen anë trajtat

e delikatesës, pa kenë nevoja me ra aspak në pamfletizem, e me ndjekë këshillin e fletores Bashkimi i Kombit "tue vë gjishtin në plagë" - mbasi kenkemi "pjekun politikisht: sa duhet - për të provue serjozisht e dokumentisht ngjarjet, perjegjesat e çfrytzesat e 7 Prillit. Kujtoj, se as në ket pikë, nuk na mungon materjali.

Ndoshta dokumentat e perdorun prej nesh në ketë rasë, si edhe nder tjerat që mund të vijin, ndokujt kanë me i vrë veshin e "gjishti i vum në plagë" kà me e bënë me u pi, e atëherë, në të mujtun për me u perligjë, ka me dalë e me na thanë se na jemi tue u dhanë të huejvet në dorë argumenta që ata mund t'i përdorin kundra nesh si shqiptarë. Na po u përgjegjemi këtyne zotnivet skrupuloz, që skutavet e biravet formojn klika u a mbajn strajcen e tagjis disavet (sidomos kur këta të jenë katolikë) që qesin shtjellma kundra Klerit e elementit katolik në Shqipëri, na po u përgjegjemi e u thomi se të huejt nuk kanë nevojë që këta dokumenta t'i dijn prej nesh, për arsye se konsullatat e ministririt e tyne këtu, në të kaluemen, e kishin të radhitun jetëshkrimin e deri shqiptarit gati më të humbunit. Historija e Shqipënisë së Ré e z. N. Ivanajt është një parodi e asajë së njemendes që ka me shkruer kritiku historik i ardhëshem, tue u pështetun sidomos nder burimet e arhivavet të Belgradit e të Romës!

## PENSIONET E INVALIDITETIT KMCAP

ISSH: Si do të llogariten pensionet e invaliditetit. Dokumentacioni që duhet të dorëzoni

# Kempi, 311 personat që do të kryejnë kontrollet mjekësore

*Lista e plotë, ja kur duhet të paraqiteni pranë Komisionit Mjekësor*

Voltiza Duro

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka shpallur emrat e personave që do t'u nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit gusht për të marrë pensionin. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën me emrat e 311 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Aktimit të Aftësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin e invaliditetit nga ISSH. Të gjithë ata persona që bëhen të paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjymtime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të përfutur këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfutuesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile për të bërë kërkesën e përfutimit të pensionit të invaliditetit. Përfutuesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën e identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi. KMCAP në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendimin



përkatës jo në prani të tij dhe kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojariisht dhe nëpërmjet vërtetimit-tip. Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohe tek KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

### KRITERET

Të gjithë ata persona që bëhen të paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjymtime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Në manualin e publikuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ditën e premtë, përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë individit si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojë për të përfutur këtë pagesë. Sipas ligjit nr. 7703, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, invaliditeti klasifikohet në

tri grupe. Invaliditeti i pjesshëm është grupimi i parë, ku bëjnë pjesë të gjithë ata persona të siguruar që humbin aftësinë për punë në profesion, por janë ende në gjendje të kryejnë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAP-it. Më tej grupi i dytë klasifikohet si invaliditeti i reduktuar në rastet kur personi i siguruar bëhet i paaftë për çdo punë, ndërsa invaliditeti i plotë është grupimi i fundit i kësaj kategorije pensionesh nga i cili mund të përfutjohet të gjithë ata individë që ndodhen në kushtet e nevojës për kujdestari. Pension invaliditeti të plotë përfutjohet të gjithë ata persona që kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç. Gjithashtu, duhet që individit në 5 vitet e fundit para lindjes

së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror si dhe të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale. E drejta për të përfutur këtë lloj pensioni fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë. Ndërkohë në manualin e ISSH-së bëhet me dije se masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. "Shuma bazë e pensionit i jepet gjithë personave të siguruar. Ndërsa shtesa që i jepet personave të punësuar është 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive", - citohet në



manual. Gjithashtu, ISSH bën me dije se shumica e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Sipas ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në rastet kur përfutuesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paaftë dhe ka nevojë për një kujdestar të vazhdueshme nga një person tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15% të bazës së vlerësueshme neto. Ndërsa, një person që merr pension invaliditeti të plotë e ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shkëputje nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5% të pensionit bazë, por jo më shumë se 30% e tij.

### PENSIONI I REDUKTUAR I INVALIDITETIT

Individët të cilët kanë humbur plotësisht aftësinë për të punuar e që nuk kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit mund të përfutjohet pension të reduktuar invaliditeti. E drejta për të përfutur pension të reduktuar invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës

6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajin e pestë ose të gjashtë, para

përfundimit të kësaj periudhe. ISSH thekson se masa mujore e pensionit të reduktuar të invaliditetit është e barabartë me masën e pensionit të reduktuar të invaliditetit të llogaritur sipas masës së pensionit të plotë të invaliditetit, shumëzuar me raportin e

viteve të periudhave të sigurimit, që janë periudhat e sigurimit që i duhen pensionit të reduktuar të invaliditetit. Gjithashtu, në rastet që ka nevojë për kujdestari si dhe në rastet kur ka fëmijë në ngarkim, pagesat llogariten po njësoj si në pensionin e plotë të invaliditetit, me kushtet specifike përkatëse.

### PENSIONI I PJESSHËM I INVALIDITETIT

Ashtu si në rastet e sipërmendura, personat që bëhen të paaftë për të punuar përfutjohet në bazë të ligjit, pension të pjesshëm invaliditeti. Kushtet për ta përfutur këtë pension janë po njësoj me kriteret e renditura për 2 pensionet e tjera të invaliditetit. Ndërkohë, masa mujore e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni, që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Në manualin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit e llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.





### DOKUMENTACIONI

**Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**

- ◆ Fotokopje e kartës së identitetit.
- ◆ Certifikatë e gjendjes familjare.
- ◆ Certifikatë martesë (vetëm për aplikueset femra).
- ◆ Dy fotografi.

**Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:**

- ◆ Librezë e punës.
- ◆ Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
- ◆ Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore.
- ◆ Vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë (nëse periudha e punës nuk provohet me dokumente zyrtare).
- ◆ Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.
- ◆ Fotokopje e notizuar e diplomës së shkollës së lartë (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).

**Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:**

- ◆ Vërtetim page, sipas së cilës është dërdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formulant-tip.
- ◆ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

**Dokumentet që vërtetojnë gjendjen shëndetësore:**

- ◆ Fletë-drejtimi për në KMCAP, lëshuar nga institucione shëndetësore me shtretër, shoqëruar me fletë-dalje nga spitali, ekzaminime e dokumente të tjera plotësuese, të kërkuara kur del për herë të parë në KMCAP.
- ◆ Fletë-drejtimi nga KML për ato gjendje shëndetësore, që nuk janë objekt trajtimi në spital, sipas përcaktimit në rregullore.
- ◆ Epikrizë përcjellëse, lëshuar nga mjekë specialistë, apo konsulta e shoqëruar me ekzaminimet e nevojshme. Kur del për rikontroll duhet shoqëruar me ekzaminimet përkatëse zyrtare.
- ◆ Kartela personale dhe libri i shëndetit për të vërtetuar ecurinë e sëmundjes, ndjekjen dhe trajtimin mjekësor me ilaçe.
- ◆ Fletë-drejtimi për KMCAP, që vërteton rëndimin e gjendjes shëndetësore, e vlefshme për KMCAP, para afatit të rikontrollit.
- ◆ Raport mjekësor lëshuar nga Komisioni Mjekësor, që përcakton gjendjen shëndetësore dhe aftësinë për punë (para fillimit të punësimit ose të përfshirjes në çdo skemë sigurimi).
- ◆ Raport mjekësor i lirimit nga ushtria, lëshuar nga KMU pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak.
- ◆ Vërtetim për pagesën e paafetësisë për punë, shkaktuar nga një sëmundje e përgjithshme (për punëmarrësin).

LISTA E PERSONAVE QË DO TË PARAQITEN NË KMCAP EPROR PËR MUAJIN GUSHT 2018						
Nr.	Emër	Mbiemër	KMCAP	Data	Ora	Rrethi
<b>NEURO/KIRURGJI</b>						
1	BINAK	HOXHA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	TROPOJE
2	DIN	QELEPASHI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	TROPOJE
3	MUJE	HASANDOÇI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	TROPOJE
4	KASTRIOT	ALIAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	TROPOJE
5	MUSA	PULA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	GJIROKASTER
6	IZET	RUKO	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	GJIROKASTER
7	ARBEN	KORE	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	GJIROKASTER
8	LAVDIE	KURTI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	DIBER
9	GJERGJ	STOJANI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	DIBER
10	YLBER	KURTAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	DIBER
11	NEXHMIJE	HASA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	DIBER
12	AFERDITA	BACULI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
13	RROK	PREÇI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
14	GEZIM	BAJRAMI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
15	EDLIRA	MERÇA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
16	XHYHER	VORFA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
17	PJETER	DARDHA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
18	AGE	PALI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
19	FATMIR	IDRIZI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
20	GJOVALIN	NDOU	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
21	LULE	VJERDHA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
22	NUSH	LAKAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
23	DERVISH	LISAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
24	HAVA	TRASHANI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
25	FISNIK	KOPLIKU	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
26	NINE	PASHKJA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
27	FLORA	PERA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
28	ALEKSANDER	ILIA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
29	ZIJA	LETHIA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
30	FIQIRETE	SYKAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	08,00	SHKODER
31	GURI	XHUKELLARI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	KORCE
32	VASFI	ÇUÇKA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	KORCE
33	ANJEZA	ÇYREKU	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	KORCE

34	VALENTINA	CENOLLI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	KORCE
35	RITVAN	RAMADAN	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	KORCE
36	FRAN	LASKA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	LEZHE
37	BUJAR	GUÇE	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	LEZHE
38	MYNEVERE	NELAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	VLORE
39	LINDITA	REXHAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	VLORE
40	LAVDIRIM	DASHAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	VLORE
41	TAJAR	METAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	FIER
42	ELMAZ	ÇELA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	09,00	FIER
43	BUJAR	KARAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	ELBASAN
44	SHEFQET	HASFATIJA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	ELBASAN
45	ZEGJINE	KORRA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	ELBASAN
46	FATMIR	LLESHI	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	ELBASAN
47	FATMIR	BICA	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	ELBASAN
48	TEFTA	LAMAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	DURRES
49	ASTRIT	SADIKU	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	TIRANE
50	DYLBERE	MICAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	TIRANE
51	KUJDESI	SHEHU	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	TIRANE
52	ELMIRA	HASANAJ	NEURO/KIRURGJI	08.08.2018	10,00	TIRANE
<b>PATHOLOGJI</b>						
53	ELENI	TYTO	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	GJIROKASTER
54	SHUKRI	TROCI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DIBER
55	ADELINA	KURTI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DIBER
56	SOKOL	GOÇI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	KUKES
57	GEZIM	HOXHA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	KORCE
58	LIRJANA	LATKA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	KORCE
59	DHIMITER	ELEZI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	KORCE
60	ROLAND	CECI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	VLORE
61	ANETA	HOXHAI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	VLORE
62	MEVLAN	HITAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	VLORE
63	XHEMALIJE	HOXHAI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
64	LIN	ÇEKAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
65	RAMAZAN	KULURI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
66	IRFAN	VESELAGA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
67	GJELINE	PLLUMAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
68	DAVE	NDOCI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
69	NDUE	GJOKA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER

70	LLESH	NIKOLLI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
71	NDUE	BRAHIMI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
72	PELLUMB	DEDA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
73	GJYSTE	NIKA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
74	DRANDE	KULLA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
75	KOLË	ÇEKINI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
76	DILE	GJERGJVATAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
77	ASTRIT	DUROVI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
78	ZEF	SHKOZA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
79	VJOLLCA	DEDA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
80	PREKE	SHTYLLZAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	SHKODER
81	PASHK	NDOKU	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	LEZHE
82	LAVDIJE	HOXHOLLI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
83	IKE	ÇELA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
84	FLORENC	DEDJA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
85	AVNI	XHAFA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
86	EDMOND	KASA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
87	MAJLINDA	TRIMI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	ELBASAN
88	DILE	HOXHA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	FIER
89	SAFETE	HUDHRA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	FIER
90	VASIL	GJINI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	FIER
91	HALIM	ÇUPANI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DURRES
92	MARIJE	GJERA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DURRES
93	TASIM	REKA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DURRES
94	MRIKE	NDUJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DURRES
95	XHEMAL	XHAKOLLI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	DURRES
96	SABRI	ÇELA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	KAVAJE
97	MYSLYM	FUÇIA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
98	MAKSUT	FEKUSHI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
99	FATBARDHA	SHABANAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
100	GJOK	UKCAMAJ	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
101	TATJANA	MUÇA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
102	LEFTERI	KORÇA	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
103	ZARE	IDRIZI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
104	VALBONA	TOPUZI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
105	ALIDIJE	MATUSHI	PATHOLOGJI	03.08.2018	08,00	TIRANE
<b>KIRURGJI</b>						

106	SAFET	MATMUJA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	KUKES
107	MARJETA	ÇULLI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	GJIROKASTER
108	ETLEVA	GORRI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	GJIROKASTER
109	HANKO	GORICI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	GJIROKASTER
110	HATIXHE	BURHANI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	GJIROKASTER
111	SOFIA	BILICA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	GJIROKASTER
112	FERIDE	ISAKU	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
113	ESAT	LECI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
114	BUKURI	XHAMXHIU	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
115	AGIM	HYSENAJ	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
116	LUFTIME	XHURXHI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
117	LAVDIE	MIFTARI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
118	PELLUMB	HIMA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	DIBER
119	GJYSTE	PALOKA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
120	MIRJANA	SAMINA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
121	GITA	DEDA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
122	SHPETIM	GUCIJA	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
123	GJERGJ	PREÇI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
124	GJON	LLESHI	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
125	GJON	KOMDAÇAJ	KIRURGJI	14.08.2018	08,00	SHKODER
126	RRUSHKE	MUÇO	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
127	STAVRO	VASILU	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
128	FOTI	LIKA	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
129	LILJANA	KANANI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
130	LILJANA	MANÇELLARI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
131	VALENTINA	FEJZOLLI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	KORCE
132	SALIBE	KABILAJ	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	VLORE
133	EVGJENI	VEIJAJ	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	VLORE
134	DALLANDYSHE	LAMA	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	VLORE
135	AURORA	MYFTARI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	BERAT
136	VELIKO	SHEME	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	BERAT
137	VALE	SHKIRA	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	FIER
138	RRAHMËN	KAJOLLI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	FIER
139	SHPETIM	MERKO	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	FIER
140	AGRON	KORRA	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	ELBASAN
141	SABIRE	SINANI	KIRURGJI	14.08.2018	09,00	ELBASAN
142	RESMIJE	BASHMETA	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	KAVAJE
143	PRENG	STOJANI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	DURRES
144	SHABAN	ARUCI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	DURRES
145	ELMIRA	IBRA	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
146	NAZMI	SHKRETA	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
147	KUMRUE	RUÇI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
148	MIMOZA	VESELI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
149	FATMIRA	RAVOLLU	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
150	PRANVERA	SINAKOLI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
151	SHPREZA	KOÇI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
152	PRENG	GJINI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
153	SULEJMAN	PICARI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
154	ZOJE	LLOCI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
155	ESMERALDA	MIRAKA	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
156	BAJRAM	TOPALLI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
157	MIRANDA	AHMETLLARI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
158	MIKLOVAN	SHABANI	KIRURGJI	14.08.2018	10,00	TIRANE
<b>KARDIOLOGJI</b>						
159	VASIL	KOÇANINI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SARANDE
160	HAKI	AXHAMI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KUKES
161	LINDITA	BALAVIJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KUKES
162	NAZMIJE	THAÇI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KUKES
163	GEZIM	ALIKO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	GJIROKASTER
164	QEMAL	HALLA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	GJIROKASTER
165	DHIOLETE	SHEHU	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	GJIROKASTER
166	OHONIS	PROKO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	GJIROKASTER
167	DRITA	HOXHA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
168	AGIM	ÇELEPIJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
169	BERHAN	BARANI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
170	PASHUK	LLESHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
171	GJON	GURI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
172	DEDE	NDREU	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
173	LEONARD	GJERGJI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	SHKODER
174	BARDHYL	TARUSHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
175	ARIF	KUKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
176	MANXHAR	ZENELI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
177	ADRIAN	EMINI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
178	DEFRIAM	ALLA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
179	MIRELA	MURIZI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
180	TRENDIAFILE	METE	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
181	SHPETIM	CANE	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
182	JANI	PANO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
183	VIKTOR	TEROLLI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
184	AREFI	SEITLLARI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
185	SAMEDIN	MULLALLI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
186	GJERGJI	THIMIO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
187	ELIVERTA	STRORA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KORCE
188	RAPO	KABILAJ	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
189	HAVA	KASHURI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
190	KASTRIOT	RESULAJ	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
191	JORGJI	PAPA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
192	PETRIT	DERVISHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
193	JANAQO	LEKAJ	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	VLORE
194	YLLI	KAJO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
195	VASILAQ	MILE	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
196	NASIP	QATO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
197	KUJTIM	BAXHIA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
198	VIKTOR	SINJARI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
199	ILIA	DHIMA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
200	DULE	KOLLDANI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	BERAT
201	VASILAQ	PETO	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
202	YLLI	VELIAJ	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
203	NAZMI	KAPAJ	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
204	XHELAL	HOXHA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
205	ALI	BYTYÇI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
206	MAKSIM	HAZIZI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
207	SAZAN	KORÇARI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	FIER
208	KOLË	FIZI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	LEZHE
209	KUJTIM	FASLLIJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	LEZHE
210	LUAN	HOXHA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	ELBASAN
211	YMER	MUSTA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	ELBASAN
212	RAJMONDA	SALLIU	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	ELBASAN
213	NIKO	MIRAKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	ELBASAN
214	QEMAL	LOKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES
215	SABA	DURMA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES

216	ISMAIL	KEPI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES
217	ILIR	NOGA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES
218	LUTFIJE	HAKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES
219	SABA	STEMA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	DURRES
220	NEXHMI	ARMADHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KAVAJE
221	TAIP	GJONI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KAVAJE
222	SHPRESA	BUTHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KAVAJE
223	AGRON	KAJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KAVAJE
224	ISMAIL	MERKJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	KAVAJE
225	YLLI	KOLA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
226	EDMOND	BARUTI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
227	SAMI	JOVANI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
228	RAHMAN	HOXHA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
229	SHKELQIM	SIMONI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
230	GENTJAN	BOGDANI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
231	GEZIM	LIKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
232	HATTJE	CUKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
233	SHABAN	KAPLLANI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
234	QEMAL	ÇOKU	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
235	ARIAN	HAKA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
236	AVNI	DUSHA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
237	LUMTURIE	SHEHI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
238	ALEM	TAFILI	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
239	SHEFKI	SEFA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
240	HARUJE	LOKJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
241	BESIM	DEDJA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
242	FATIME	BASRIU	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
243	KUJTIM	ÇEÇA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
244	SHKURTE	DUNGA	KARDIOLOGJI	23.08.2018	08,00	TIRANE
<b>ORTOPEDI</b>						
245	KORAB	KOKA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	KUKES
246	DIFE	XHYLA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	DIBER
247	ZIRA	SINA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	DIBER
248	RABIAN	CANE	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	KORCE
249	DRITAN	SHANO	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	KORCE
250	VIKTOR	HOXHALLI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	KORCE
251	LENE	VUKAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
252	VITORE	PEPAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
253	ALFRED	MAZI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
254	AFRIM	LLUKA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
255	BILAL	DUSHI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
256	GJERGJ	ÇUNI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
257	NIMET	DUSHAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
258	BLERTA	JAKAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
259	DIELLE	BRULAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
260	XHYHERE	MEMÇAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
261	ILIRJANA	PREKA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
262	GJYLJANA	FJERCE	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	SHKODER
263	LLESH	MATRIZI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	LEZHE
264	AGRON	GJONAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	LEZHE
265	GJELINA	GJIKOLAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	LEZHE
266	MARTE	LLESHI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	LEZHE
267	GJOK	DEDA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	LEZHE
268	REFIDE	GOXHABELLIU	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	BERAT
269	HAVAJETA	QAMILI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	FIER
270	DHIMITRIJE	GORREJA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	FIER
271	GRACIANO	MEÇAJ	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	FIER
272	RUBIE	LEKA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	ELBASAN
273	FLUTURAKE	TABAKU	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	ELBASAN
274	ISMA	RAPI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	ELBASAN
275	SHKENDI	RUSI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	ELBASAN
276	FLUTRA	MUSTAFA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	KAVAJE
277	SANJE	KEPI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	TIRANE
278	NAZE	BOJA	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	TIRANE
279	MHERIE	SHURDHI	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	TIRANE
280	HYSEN	MYRTO	ORTOPEDI	31.08.2018	08,00	TIRANE
281	BARDHYL	DIBRA	ORTOPEDI			






## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Si të kuroni tensionin  
e lartë të gjakut me  
uthullën e mollës

## KESHILLA



Frutat dhe  
perimet që s'duhet  
t'i ndani nga tryeza  
këtë muaj

# Albana Duni:

◆ Mjekja  
gastrohepatologe:  
Cilat janë  
simptomat  
kryesore të  
sëmundjes,  
që s'duhet  
neglizhuar



## Si të trajtoni refluksin gastro-ezofageal

"Lini duhanin e alkoolin,  
kujdes me mbipeshën"

• 9 këshilla për të mbrojtur lëkurën nga dielli në stinën e verës

Mjekja gastrohepatologe: Cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes, që s'duhet neglizhuar

# Albana Duni:

## Si të trajtoni refluksin gastro-efozageal

"Lini duhanin e alkoolin, kujdes me mbipeshën"

Voltiza Duro

Në ndër sëmundjet më të shpeshta të ezofagut është edhe refluksi gastro-efozageal, që lidhet me rikthimin e sekrecioneve të stomakut në ezofag. Nëse kjo sëmundje nuk trajtohet, mund të shkaktojë dëmtim të mukozës së ezofagut në trajtën e erozioneve apo ulcerave dhe më rrallë me shfaqjen e kancerit kardio-efozageal. Por përveç kësaj, mund të çojë edhe në laringit kronik, ndryshime të zërit, kollë kronike, kruajtje të zërit, granulomë të kordave të zërit dhe probleme të tjera. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon të gjitha simptomat kryesore të refluksit gastro-efozageal si dhe mënyrat e trajtimit të tij. Më tej mjekja paralajmëron se pacientët e prekur nga kjo sëmundje duhet të ndryshojnë stilin e jetesës, duke filluar me lëniën e duhanit e alkoolit.


**Çfarë është refluksi gastro-efozageal dhe pse shkaktohet kjo sëmundje?**

Sëmundja e refluksit gastro-efozageal është më e shpeshtë e ezofagut dhe ka të bëjë me rikthimin e sekrecioneve të stomakut në ezofag. Ky rikthim ndodh si pasojë e humbjes së tonusit të sfinkterit të poshtëm gastro-efozageal, që ndodhet në vendbashkimin e ezofagut me stomakun. Ky sfinkter ka rolin

e një valvule funksionale, e cila hapet sa herë ne ushqehemi ose pimë. Në rastin e humbjes së tonusit të kësaj "valvule", kjo do të ngelet hapur për një kohë të gjatë dhe lëngjet gastrike do të rikthehen mbrapsht në ezofag. Edema e kordave vokale të vërteta mund të ndryshojë nga e lehtë deri në të rëndë, edema e rëndë ka paraqitjen e një pjese polipoide. Edema e kordave vokale në këtë shkallë mund të rezultojë me një ngjirje zëri të rëndë, stridor ose kompromentim të rrugëve të

frymëmarrjes. Edema zhvillohet në shtresën superficiale të lamina propria të kordave vokale të vërteta e quajtur gjithashtu si hapësira Reinke. Kështu, shpesh referohet si edema Reinke. Prezenca e edemës në kordat vokale të vërteta është një sugjerues i lartë i refluksit laringo-faringeal.

**Cilat janë disa prej simptomave**



**Kryesore që shfaqin pacientët?**

Prezantimi më tipik i kësaj sëmundjeje është djegia e kraharorit dhe rikthimi acid në ezofag. Rreth 20-60% e pacientëve me refluks kanë ankesa në grykë pa pasur ndonjë ankesë si "djegie gjoksi" të dukshme. Simptoma atipike më e shpeshtë që jep refluksi gastro-efozageal është ngecja e një dëçkaje në fyt, që ne e quajmë "gلوبus faringeal", shenjë kjo që mund të ngatërrojë mjekun dhe mund të ndryshojë drejtimin e ndjekjes së problemit, duke harruar kështu shkaktarin, stomakun. Simptoma të tjera përfshijnë kruajtjen konstante të zërit (shkakuar nga rrit-

### SIMPTOMAT E GRYKËS TË PACIENTËT ME REFLUKS GASTRO-EZOFAGEAL:

- Aerofagi
- Djegie goje
- Dhimbje cervikale
- Ndjesi e mbytjes
- Kollë kronike
- Pastrimin e vazhdueshëm të fytit (kruajtje e zërit)
- Disfagi
- Fërkim i ushqimit në fyt
- Ndjenja e ngecjes së një dëçkaje në fyt
- Erë e keqe nga goja
- Ngjirje zëri (disfonia)
- Dhimbje veshi
- Ngushtësi e faringut
- Dhimbje fyti
- Ujë në gojë



Mjekja gastrohepatologe Albana Duni

### NDRYSHIMET E STILIT TË JETES QË MUND TË PËRMIRËSOJNË REFLUKSIN:

- Shmangni ushqimet me yndyrë, kafeinën (kola, kafe, çaj, çokolatë, mente, ushqime të skuqura, ushqime me bazë domate, hudhra dhe qepë.
- Ndaloni duhanin.
- Ndaloni ose ulni përdorimin e alkoolit.
- Humbni peshën nëse jeni mbipeshë.
- Ngrini kokën e krevatit 10-20 cm
- Hani vakte të vogla.
- Shmangni veshjet e ngushta.
- Shmangni ngrëniet e vona, të paktën 4 orë para gjumit.
- Shmangi shtrirjen të paktën 3 orë pas ngrënies.
- Shmangni medikamentet që ulin presionin në sfinkterin e poshtëm ezofageal.

ja e sekrecioneve dhe ngacmimi i mukozës laringeale), ngjirja e zërit, dhimbje kronike gryke, kollë, vështirësi në gëlltitje, erë e keqe nga goja, djegie goje, dhimbje veshi, fërkim i ushqimit në fyt, ngushtim i fytit, ndjesi mbytjeje, gëlltitje ajri, si dhe ujë në gojë.

**Si mund të bëhet diagnostikimi i sëmundjes?**

Laringoskopia mund të konfirmojë diagnozën e refluksit aringo-faringeal dhe gastrokopia mund të konfirmojë refluksin gastro-efozageal. Gjatë këtij ekzaminimi kemi parë skuqje të laringsit posterior dhe trashje të kordave vokale.

**Cilat janë mënyrat e trajtimit të refluksit gastro-efozageal?**

Trajtimi duhet filluar me frenues të acidit gastrik si dhe me ndryshimin e stilit të jetesës. Sfinkteri i sipërm ezofageal shërben si barriera kryesore për parandalimin e refluksit laringo-faringeal. Barriera primare e refluksit gastro-efozageal është sfinkteri i poshtëm ezofageal.

Nëse historia dhe ekzaminimi fizik dështon në zbulimin e patologjive serioze, pacientët me refluksi gastro-efozageal të dyshuar mund të fillojnë një terapi empirike, që kryesisht konsiston në modifikimet e stilit të jetës dhe të terapisë medikamentoze. Vlerësimi kërkohet nëse pacientët nuk i përgjigjen terapisë empirike ose kur ato shfaqen me refluks të përsëritur. Ndërhyrja kirurgjikale mund të kërkohet në këta pacientë.

**Cilat janë pasojat e mostrajtim-it të sëmundjes?**

Pasojë e sëmundjes së zgjatur dhe të patrajtuar të refluksit gastro-efozageal është dëmtimi i mukozës së ezofagut në trajtën e erozioneve apo ulcerave dhe më rrallë me shfaqjen e kancerit kardio-efozageal. Nëse refluksi gastro-efozageal ngelet i patrajtuar përveç dëmtimit të mukozës së ezofagut, mund të çojë edhe në laringit kronik, ndryshime të zërit, kollë kronike, kruajtje e zërit, granulome e kordave të zërit dhe probleme të tjera.



Voltiza Duro

**T**ë gjithë ata persona që janë obezë kanë probleme me mëlcinë e kapsllëkun duhet të informohen mbi mënyrën e trajtimit të problemeve të tyre. Uthulla e mollës është një prej preparateve që ndihmon në kurimin e një sërë problemesh në organizmin e njeriut. Midis përbërësve të shumtë, kjo uthull përmban acid malik në përqindje të lartë, acid tartrik, acid tartarik dhe peptina. Nëse mund të mendoni se ky frut nuk duhet të përdoret pasi sjell dëmtime në stomak, gabohehi, pasi peptina që ndodhet në përbërjen e këtij fruti është një qetësues i mrekullueshëm i stomakut. Ju duhet të lexoni me kujdes recetat se kur duhet të përdoret uthulla e mollës.

**Dobitë në organizëm**

Uthulla e mollës ul tensionin e lartë të gjakut, ndihmon në rastin e sëmundjeve të fytit dhe është një rregullator shumë i mirë i tretjes së çrregulluar, metabolizmit dhe qarkullimit të dobët të gjakut. Uthulla e mollës gjithashtu bën të mundur ruajtjen e një peshe standarde, lufton mykun në organizëm, kondilomat, parazitët në kokë, balancon sistemin e brendshëm të gjendrave endokrine si dhe ndihmon në stimulim e qarkullimit kardiovaskular dhe pastrues i gjakut nga pllakëzat dhjamore. Gjithashtu, shërben si luftues i sëmundjeve mykotike te bimët si dhe fluturën e bardhë e tenjën e rrushit. Ky produkt natyral meriton një vend të veçantë në tempullin e shëndetit të njeriut. Për të luftuar lodhjen kronike, përzieni 3 lugë të vogla me uthull molle dhe një filxhan mjaltë, e masën vendoseni në një kavanoz dhe çdo mbrëmje para fjetjes konsumoni një lugë çaji nga kjo përzlerje. Do të vini re që ditën tjetër do të jeni më të "freskët" për punë. Për të pasur rezultate kundër dhimbjeve të kyçeve të shkaktuara nga artriti reumatoid, ose kalcifikime bëni mirë të mbështillni vendet që iu dhembin me uthull molle dhe pak mjaltë dhe mbi të vendosni një garzë për të mos u fshirë uthulla nga rrobat. Përveç kësaj, është mirë që të pihen 1-2 lugë çaj nga uthulla e mollës së përgatitur. Për rënie të peshës trupore, provoni të pini çdo mëngjes esëll, 1 gotë ujë ku keni hedhur 1-2 lugë gjelle me uthull molle dhe fare pak piper të zi. Brenda pak ditësh do ta ndjeni trupin më të



**Mjeku popullor: Si ta përgatitsni këtë produkt natyral në kushte shtëpie, receta**

# Ylli Merja: Si të kuroni tensionin e lartë të gjakut me uthullën e mollës

*"Shërben si rregullatore e qarkullimit të gjakut"*



Mjeku popullor Ylli Merja

lehtësuar. Ndërsa për të luftuar zgjerimin e venave (vena merimangë) çdo mëngjes dhe mbrëmje masazhoni lëkurën mbi venat e zgjeruara me një filxhan ujë dhe një lugë gjelle uthull molle. Ndërsa gjatë ditës mund të hidhni në ushqim 1-2 lugë gjelle uthull molle të pastër. Kjo e fundit

mund të detoksifikojë shtëpinë tuaj, e nëse merrni uthull nga mollët e egra dhe ta përdorni si për pastrimin e sipërfaqeve të tavolinave, tualetit apo lavamanit, ju do të vini re se ato marrin një shkëlqim krejtësisht të veçantë. Uthulla e mollës së egër luan një rol të rëndësishëm për flokë plot shkëlqim e mund të përdoret si një shpëlarës i flokëve pas shamos, pasi ndikon në rritjen e volumit të tyre dhe pastron zbokthin. Për këtë, në një litër e gjysmë ujë, hidhni një lugë e gjysmë gjelle me uthull molle, pasi do të rregullojë edhe pehashin e lëkurës suaj, ku me ndihmën e një pambuku lëngu përhapet në lëkurë. Por kjo mund të vendoset edhe mbi aknet, lythat, ose kondiloma. Lëkura në këto raste duket sikur irri-tohet, por lythat bien, ndërsa kur përdoret për kondilomat, garzat me uthull molle të përgjendruar vendosen të shoqëruara me pak huder të shtypur. Kjo uthull ndikon edhe në zbardhjen e dhëmbëve dhe lehtësimin e djegieve nga dielli, madje edhe si një solucion pas rroje ose pas depilimit. Uthulla e mollës së egër jep një kontribut të çmuar për sistemin limfatic, pasi ndihmon dhe pastron nyjat limfatike, pasi edhe vetë studimet shkencore sugjerojnë që kjo tretësirë të përdoret në luftimin e alergjive, për shkak se është antimykotike dhe nxit hapjen e sinuseve.



# këshilla për të mbrojtur lëkurën nga dielli në stinën e verës

# 9

Nxirja më e mirë është ajo graduale dhe natyrale. Për të shijuar plotësisht të gjitha këto përfitime, duhet të dimë të ekspozohemi në diell. Më poshtë po japim disa këshilla të rëndësishme mbi mbrojtjen e lëkurës nga rrezet e forta të diellit në këto ditë të nxeh-ta gushti.

### Ekspozim gradual

Mos u ekspozoni shumë gjatë në dy-tri ditë e para. Në fillim mos qëndroni më shumë se treçerek ore në diell në ditë (20 minuta në diell të fortë). Përtej këtij limiti nuk prodhohet më melaninë. Nxirja sipërfaqësore e ditëve të para është për shkak të melaninës së gatshme, por është e destinuar të zhduket shumë shpejt. Vetëm pas një jave fillon të formohet nxirja që zgjat. Pas ditëve të para mund të shtoni gradualisht kohëzgjatjen në diell, pa harruar mbrojtjen e duhur.

### Mbrojtja

Ka ende njerëz të bindur që kremrat kundër diellit pengojnë nxirjen perfekte. Në fakt, pa krem jo vetëm që nuk nxihesh më mirë, por rrezikon të digjesh dhe krijimin melanomave. Kremi i diellit i zgjedhur në bazë të llojit të lëkurës është i domosdoshëm për të mbrojtur lëkurën nga rrezet UVA dhe UVB, që janë shkak i krijimit të tumoreve të lëkurës dhe plakjes së parakohshme. Çfarë ndodh nëse nuk zgjidhet kremi i duhur? Do të skuqeni, do të digjeni dhe ngjyra do të zgjasë shumë më pak. Kremi aplikohet 30 minuta para ekspozimit në diell, çdo dy orë dhe pas çdo larjeje në det. Përdoreni kremin edhe nëse keni marrë tashmë ngjyrë.

### Koha e ekspozimit në diell

Koha më e mirë për t'u ekspozuar në diell për një nxirje të shëndetshme është mëngjesi deri në orën 11 dhe pasdita e vonë pas orës 15:00. Evitoni orët e drekës nga 12:00 deri në 15:00. Mos ekspozoni fëmijët nën 3 vjeç gjatë orëve të pikut. Sa më e madhe të jetë sasia e rrezeve të marra, aq më i madh është rreziku për t'u shfaqur tumore në moshë të madhe.

### Mos përdorni parfume në diell

Për të evituar reaksionet alergjike apo mbindjeshmëri të lëkurës, mos hidhni parfume apo ujë trupi me bazë alkooolike para se të ekspozoheni në



Nxirja sipërfaqësore e ditëve të para është për shkak të melaninës së gatshme, por është e destinuar të zhduket shumë shpejt. Vetëm pas një jave fillon të formohet nxirja që zgjat. Pas ditëve të para mund të shtoni gradualisht kohëzgjatjen në diell, pa harruar mbrojtjen e duhur.

diell. Nëse merrni ilaçe, këshillohuni me mjekun. Më mirë lini mënjane vajrat nxirës, nuk u japin ngjyrën e bukur të plazhit. Më mirë zgjidhni një krem "pas diellit" për të hidratuar dhe rinfreskuar lëkurën.

### Hidratimi i lëkurës

Hidratimi i lëkurës është thelbësor për të evituar tharjen dhe rrjepjen e saj. Prandaj është shumë e rëndësishme të pini shumë ujë dhe të përdorni kremra hidratues. Janë të shkëlqyer vaji i arganit dhe gjalpi shea.

### Mbroni sytë

Dielli nuk dhuron vetëm një ngjyrë të bukur të lëkurës, por mund të jetë i dëmshëm për sytë. Mbani kapele dhe syze dielli me lente kundër rrezeve UVA dhe UVB.

### Thahuni

Efekti pasqyrë i pikave të ujit pas një larjeje në det favorizon djegiet e diellit dhe redukon efikasitetin e produkteve të mbrojtjes edhe nëse ato janë rezistente ndaj ujit dhe mund të favorizojnë djegiet dhe dehidratimin. Prandaj fshihuni mirë pas çdo larjeje.

### Përdorni kremin mbrojtës

Bëni një dush me ujë të ëmbël për të hequr gjurmët e kripës së detit (ose klorit nëse keni qenë në pishina). Lyhuni me krem pas diellit, pas ekspozimit në diell lëkura duhet hidratuar gjithmonë që të jetë elastike dhe të ruajë më gjatë nxirjen.

### Kujdes me dietën

Mos lini pas dore këshillat ushqimore për një nxirje perfekte. Ushqimet e pasura me vitamina janë të gjendje t'i japin lëkurës hidratimin e duhur: Vitamina C (speca agrume dhe kivi), Vitamina E (vezë, brokoli), Vitamina A betacarotene (perime me tul të kuq ose të verdhë, karota) që i japin lëkurës një tonalitet të artë. Pini shumë ujë dhe shpesh.





# Këshilla

## Pse duhet ta konsumoni qumështin e dhisë

**Q**umështi i lopës mbetet një nga produktet më të konsumuara çdo ditë nga shqiptarët, por ky qumësht është arsyeja përse shumë njerëz përjetojnë fryrje dhe probleme të tjera me tretjen. Qumështi i dhisë nga ana tjetër është një alternativë më e shëndetshme. Dhinë prodhojnë 2 për qind të sasisë globale të qumështit, e njerëzit që konsumojnë qumësht dhie janë më pak të prekur nga alergjitë dhe problemet me tretjen. Sipas studimeve, qumështi i dhisë përmirëson shëndetin në shumë mënyra të ndryshme. Qumështi i dhisë nuk shkakton inflamacion, ndaj rekomandohet për njerëzit që vuajnë nga inflamacioni i zorrëve. Studimet kanë konfirmuar se qumështi i dhisë rrit përthithjen e hekurit dhe bakrit, sidomos tek njerëzit që kanë probleme me tretjen.

Një nga vlerat kryesore të qumështit të dhisë është se ngjan shumë me qumështin e gjirit. Përmbajtja kimike e tij është shumë e përafërt me qumështin e gjirit, ndaj tretet dhe asimilohet më lehtë nga organizmi.

Sipas informacioneve, përmasat e molekulave të yndyrave tek qumështi i dhisë janë më të vogla se ato tek qumështi i lopës. Kjo e



bën qumështin e dhisë më të lehtë në tretje. Qumështi i lopës përmban 17 për qind acide yndyrorë,

ndërsa ai i dhisë plot 35 për qind. 50 për qind e njerëzve që janë të ndjeshëm ndaj qumështit e kanë më të lehtë të konsumojnë qumështin e dhisë se atë të lopës. Ky lloj qumështi përmban jo vetëm kalcium, por edhe triptofan, një aminoacid i rëndësishëm për organizmin. Qumështi i lopës ka lidhje më të fortë me alergjitë dhe sekrecionet e tepërta, për shkak të molekulave të mëdha të yndyrës. Qumështi i dhisë nuk shkakton alergji dhe është më i butë me stomakun. Qumështi i dhisë është përdorur tradicionalisht për të ushqyer dhe rigjallëruar sistemin nervor. Ai ka një dendësi të madhe ushqimore dhe në një gotë të vetme plotëson 35 për qind të nevojës ditore për kalcium. Një gotë me qumësht dhie ofron shumë fosfor, vitaminë B-12, proteinë dhe kalium. Qumështi i dhisë përmban selenium, një mineral i rëndësishëm për sistemin imunitar dhe mbarëvajtjen e organizmit.



## Frutat dhe perimet që s'duhet t'i ndani nga tryeza këtë muaj

**M**ënyra më e mirë për ta përballuar luhatjen e ekstreme të temperaturave është padyshim të ushqyerit shëndetshëm, duke shijuar frutat dhe perimet e bollshme që ky muaj na ofron. Duke qenë se jemi pak javë larg përfundimit të verës, po japim disa rekomandime mbi frutat dhe perimet që duhet të konsumoni gjatë kësaj periudhe.

### RRUSHI

Rrushi i zi apo i bardhë është një zgjedhje që ju takon ju, sipas shijes dhe preferencave, por të dy këto lloje i gjeni me bollëk në treg. Zgjidhni rrush të formuar mirë dhe me lëkurë të fortë. Vendoseni rrushin të mbyllur në mënyrë hermetike në qese plastike në frigorifer. Mos i lani derisa të jetë momenti për t'i ngrënë. Nëse ato kanë lagështi në momentin që i blini, vendosini një kartëpecetë brenda në qese për të thithur lagështirën e tepërt.

### PJESHKAT, NEKTARINAT

Pjeshkat dhe nektarinat janë mbretëreshat e sezonit të verës. Ndërshimi i vetëm është se pjeshkat janë më të forta dhe me push dhe nektarinat janë më lëkurë më të lëmuar. Më të apasionuarit e këtyre frutave mund të argumentojnë se shija e pjeshkës është shumë më e fortë, ndërsa ajo e nektarinave, kajsive ka nuanca të shijes së

limonit. Mënyra më e mirë për të zgjedhur pjeshkat dhe kajsitë më të mira qëndron tek ngjyra e tyre. Sa më portokalli të jenë, aq më të ëmbla dhe të mira janë. Por mbi të gjitha, asaj që duhet t'i besosh më shumë është nuhatja. Pjeshkat dhe nektarinat më të mira kanë një aromë të pazezistueshme.

### LAJTHI

Kuzhinierët i konsiderojnë arrorët si element kryesor në kuzhinë, njësoj si mielli apo gjalpi. Pavarësisht se lajthitë i kemi gjatë të gjithë vitit, gjatë sezonit të tyre ato kanë një shije unike. Lajthitë e hapura mund të ruhen në temperaturën e mjedisit për disa javë. Ndërsa ato me lëvozhgë mund të futen në frigorifer ose akoma më mirë vendosini në një qese plastike dhe futini në ngrirje. Do ju zgjasin për rreth një vit.

### KUNGULL I NJOMË

Ka më shumë se 100 varietete kungujsh të njomë, të cilët variojnë në ngjyra që nga jeshile në gri në pothuajse të zezë dhe në forma nga të gjata dhe të holla si hot dog tek ato të mëdhenj të rrumbullakët, që janë dhe kungujt klasikë.

### KUMBULLA

Ka aq shumë varietete kumbullash sa që nuk ua merr mendja. Dhe si të mos mjaftonte kjo, kanë nisur që kumbullat t'i shartojnë edhe me pjeshkë duke krijuar akoma më shumë varietete.





## TRASHEGIMIA KULTURORE



Gjatë zbulimeve arkeologjike

## Zbulime Arkeologjike në Shqipëri, tri epoka të ndryshme nga 8000 vite para Krishtit

Shqipëria zbulon sitin më të madh arkeologjik, ku ruhen tri epoka të ndryshme nga 8000 vite para Krishtit deri tek 1000 vite pas Krishtit. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro dhe Michele Elia, menaxher i TAP në Shqipëri vizituan një nga sitet e gërmimeve arkeologjike në gjurmën e gazsjellësit TAP në vendin tonë, ku janë zbuluar vendbanime të periudhës prehistorike e deri në Mesjetën e vonë, si dhe shumë objekte arkeologjike. Projekti i ndërtimit të gazsjellësit TAP është zhvilluar paralelisht me proceset arkeologjike. "Dua të theksoj se gazsjellësi TAP është një ndër bashkëpunimet më të mira që ne kemi me zhvillimet industriale dhe që tregon në të njëjtën kohë që nuk janë të papajtueshme trashëgimia kulturore dhe zhvillimi industrial i vendit, mjafton të kemi bashkëpunim dhe të ruajmë standardet", - u shpreh Kumbaro. Ndër rajonet ku janë zbuluar më tepër site arkeologjike janë Korça, Berati dhe Skrapari. Përmes këtij projekti është krijuar mundësia të zbulohen site arkeologjike dhe vendbanime të rëndësishme për njohjen, humtimin dhe ekspozimin e trashëgimisë sonë arkeologjike. Michele Elia theksoi se, "TAP është shumë i vëmendshëm në këtë projekt, nuk shihet vetëm ndërtimin e tubave, që në fakt është tërësisht infrastrukturë, por edhe gjithçka me të cilën përballim në rrugëtimin e saj kthehet në oportunitet për territorin, qoftë nga pikëpamja sociale ambientale, apo kulturore. Ne jemi të impenjuar të ruajmë nive-



lin më të lartë të standardeve jo vetëm rajonale, por edhe ndërkombëtare". Nga gërmimi arkeologjik i

shpëtimit deri tani janë zbuluar rreth 600 varre, rreth 11 site arkeologjike, të cilët datojnë nga peri-



udha helenistike, periudha prehistorike (bronzit i vonë) e deri në periudhën otomane. Këto materiale

janë në proces studimi. Me shumë interes arkeologjik në këtë gërmim është zbulimi i një vendbanimi të

periudhës neolitike. "Në të gjitha sitet e hapura që realizohen në bashkëpunim me arkeologët, jo vetëm gërmimet kanë qenë interesante, por ka qenë një treg pune shumë i rëndësishëm për punonjësit e trashëgimisë kulturore. Kemi mbi rreth 100 arkeologë dhe ndihmës arkeologë të punësuar, që tregon se potenciali i zhvillimit industrial sjell edhe potencial të zhvillimit të tregut të trashëgimisë kulturore", - u shpreh Kumbaro. Realizimi i gërmimeve arkeologjike, zbulimi i siteve të reja arkeologjike po mundësohet vetëm falë projektit TAP, përgjatë zbatimit të cilit janë zbatuar kriteret dhe standardet më të larta të zbatimit të ligjit në fushën e trashëgimisë kulturore.





Opinioni *i* Ditës

# Shkëmbim territoresh Serbi-Kosovë, ja modelet që u diskutuan nga Meta e Xhinxhiç në 2002

Nga Edmond Haxhinasto

... kontributorët në debat pak merren me thelbin e çështjes e shumë merren me njëri-tjetrin, a thua se sharjet sa më të mëdha për personin janë kontribut më patriotik për thelbin delikat e me rëndësi kombëtare. Në fakt, sa më shumë merremi me personat dhe jo me çështjen, aq më pak i shërbejmë rëndësisë dhe peshës që ajo realisht mbart.

Në fakt, diskutimi nuk është i ri. Personalisht jam marrë me këtë çështje diplomatikisht dhe politikisht, si këshilltar diplomatik i kryeministrit, si i Ngarkuar me Punë e.p në Beograd, kur pas takimit Meta-Xhinxhiç në 2002, u angazhuam për rrugë direkte komunikimi dhe realizuam takime mes përfaqësuesve të moderuar kosovarë e serbë, për t'i dhënë një zgjidhje sipas modelit evropian marrëdhënies Kosovë-Serbi, e më pas edhe si ministër i Jashtëm.

Disa parime e modele kanë qenë themelore: parimi i shkatërrimit të mureve (kufijve) mes popujve të rajonit, jo i ngritjes së tyre; parimi i tolerancës dhe respektit reciprok për pakicat; parimi i bashkëpunimit dhe integritetit mes popujve të rajonit, si domosdoshmëri për integrimin më të gjerë në BE.

Si model gjithnjë shërbeu ai franko-gjerman, i cili i konvertoi dy armiq të betuar në aksin e lëvizjes dhe motorin e vetë BE-së.

Me këtë model evropian punoi edhe Komisioni Ndërkombëtar për Ballkanin, i cili me 2004 propozoi pavarësi për Kosovën në Beograd dhe gjithë kryeqytetet e rajonit. Me këtë koncept punoi më pas edhe troika SHBA-Rusi-BE dhe po me këtë koncept përgatiti edhe Martii Ahtissari planin e tij të pavarësisë. Pavarësia e Kosovës në 2008-ën erdhi si pranim nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania e shumë vende të tjera, të një Kosove të pavarur, bazuar në vlerat universale të lirisë dhe të drejtave, që respektonte komunitetet etnike si pjesë themelore të shtetformimit, gjë që u mishërua në mënyrë shembullore edhe në simbolet (vjet në flamur e stemë) dhe Kushtetutën e Kosovës (mes të tjerave, edhe pjesëmarrja e garantuar në parlament e serbëve).

Një investim i jashtëzakonshëm nga SHBA, BE dhe vende të tjera ndodhi edhe më pas, për të forcur shtetin e ri të Kosovës dhe për të promovuar integrimin e saj në komunitetin ndërkombëtar, në organizata rajonale e



ndërkombëtare.

Dhe sot, tek dëgjoj këtë debat mbi shkëmbimin e territoreve, më duket se ky investim ndërkombëtar, por edhe kombëtar po rrezikohet në mënyrë serioze. Më lejoni të rendis me poshtë disa vlerësime:

1. Së pari, shkëmbimi i territoreve është një përpjekje për të krijuar shtete etnikisht të pas-tra, koncept utopik dhe i dështu-

ar në tragjedi e gjakderdhje, veçanërisht në Ballkan. Sido që të shkëmben territoret dhe të ndryshohen kufijtë, do të jetë e pamundur të mos lihen brenda tyre komunitete të një etnie tjetër. Ky është koncepti i Westfalisë, por jo i Evropës së Bashkuar ku po integrohet Kosova, Serbia dhe rajoni.

2. Rrjedhur nga sa më sipër, shkëmbimi i territoreve tradhton

pandjeshmërinë e elitave politike për të drejtat individuale e kolektive të të gjithë qytetarëve të tjerë, që nuk jetojnë në territore të shkëmbyera. Me mijëra shqiptarë jetojnë në Beograd e kudo në Serbi. Ashtu siç jetojnë serbë jashtë Mitrovicës. Çdo bëhet me ta? Apo duhet të shkojnë në shtetet etnike, nëse duan të drejta?! Pra, e këtë koncept, domethënia e numrave (pa-

kipë-shumicë) në këtë mënyrë prevalon mbi domethënien e vlerave (liritë e të drejtat si minoritete) në përcaktimin e kufijve dhe territoreve. Ky është koncepti më i gabuar për bashkëjetesën etnike në Ballkan.

3. Shkëmbimi i territoreve përbën një pararendës të rrezikshëm që energjitë e jashtëzakonshme në rajonin tonë dhe më gjerë për të respektuar minoritetet (edhe ato shtetformuese) të shkojnë/ridrejtohen drejt ndryshimit të kufijve. A mund të jetë ky modeli edhe për Bosnjën e Hercegovinën, për Maqedoninë, (nuk po përmend shumë vende anëtare të BE) e praktikisht, për çdo vend tjetër që ka minoritete. Sigurisht që jo. Nuk shoh as gatishmërinë e SHBA, as të BE për të hapur "një front" të tillë të papërballueshëm.

4. Nëse elitat politike në Kosovë e në Serbi e shohin të pamundur arritjen e bashkëpunimit dypalësh dhe integrimin në rajon dhe në BE duke respektuar konfigurimin aktual të kufijve, mendoj se ato janë të paafta për të udhëhequr vendet respektive drejt Evropës së Bashkuar dhe përbetimet e tyre për integrim në Evropë janë një hipokrizi e pastër.

5. Pretendimi se shkëmbimi i territoreve mund të japë votën e Rusisë dhe Kinës në Këshillin e Sigurimit, (dhe rrjedhimisht të sjellin anëtarësinë e Kosovës në OKB), është një mendjeshkurtësi, sepse shkëmbimi i territoreve nuk është çështja që mban veton e tyre, por ka çështje të tjera "parimore dhe strategjike", (vetëvendosja, ndërhyrja sipas Kapitullit 7 të Çarterit të OKB, etj.) të cilave nuk u jepet përgjegjësi vetëm me shkëmbime territore.

6. Dhe së fundmi, statusi aktual i Kosovës, në një proces afirmimi me BE (së shpejti liberalizimi i vizave) dhe i Serbisë (në procesin e negociimit për anëtarësim) do të merrte një goditje të rëndë dhe do të shënonte një regres të jashtëzakonshëm. Elitat aktuale politike në Beograd e Prishtinë nuk mund të marrin përgjegjësi të tilla që minojnë jo vetëm përpjekjet dhe arritjet e akumulura kombëtare, por veçanërisht ato ndërkombëtare, ku krahas SHBA-ve e BE-së, Shqipëria ka qenë kontributore jo e parëndësishme.

Prandaj mendoj se ushqimi i një koncepti të tillë të shkëmbimit të territoreve, është sa arkaik, jo-Evropian, aq edhe anti-kombëtar.

Opinion i Ditës

# Kur edhe Ivica Daçiç tenton të japë leksione qytetarie!

Nga Spartak Topollaj

(Vijon nga faqja 1)

...autoritetet serbe për të marrë pjesë në një aktivitet publik në Novi Pazar, ku edhe ishte i ftuar. Leja u refuzua për turpin, tashmë të ngrënë me bukë, të autoriteteve shtetërore policore kufitare të Serbisë. Që këtu, duke njohur politikën dhe qëndrimet idiote të politikaneve serbë, nuk ka pse të habitemi. Por habinë më të madhe, na e shkaktoi një deklaratë edhe më idiote e zv.kryeministrit të Parë e ministër i Jashtëm serb, Ivica Daçiç. Ky farë politikani e kryediplomati i Serbisë, refuzimin e lejes për Pacollin e motivoi me absurdin se nëse do e lejonin të ndodhte kjo, do të duhej të sillleshin me Pacollin, as më shumë e as më pak, por vetëm ashtu si u sollën autoritetet e Kosovës me Marko Gjuriçin. Dhe e gjitha kjo nuk paska ndodhur, ngaqë serbët ndryshe prej shqiptarëve, na tenkan të "qytetëruar"?!"

Këtu e vërteta dhe historia është sa e thjeshtë, aq edhe e qartë për këdo, por megjithatë e ndjej për detyrë të ndriçoj me fakte e argumente, se ku ndryshojnë dy rastet diametralisht të kundërta. Prej gati 20 vitesh, serbët e kanë humbur njëherë e përgjithmonë Kosovën. Ata u shporrën nga Kosova, falë Luftës Çlirimtare të shqiptarëve dhe ndërhyrjes ushtarake e bombardimeve të NATO-s, të udhëhequr nga SHBA. Prej 10 vitesh Kosova e pavarur është njohur nga 115 shtete të botës, por jo nga Serbia. Madje në marrinë kolektive të tyre, ata vazhdojnë ta konsiderojnë Kosovën pjesë e shtetit serb! Duke mos reshtur të provokuari, sidomos me të ashtuquajturën Bashkësi të Komunave Serbe dhe përkujtimet e "festimet" e humbjeve, apo ceremonitë fetare ortodokse (ku Irinej, Artemije dhe Amfilohije, pothuaj nuk mungojnë kurrë!) Në larinë provokative të paranojës serbe, një vend të veçantë zënë përpjekjet për të hyrë me forcë, nën pretekste, shpeshherë gesharake, brenda territorit shtetëror të Republikës së Kosovës, të politikaneve apo klerikëve ortodoksë serbë. Autoritetet kosovare, në shumicën e rasteve, me një tolerancë civile të admirueshme, kanë treguar një vetëpërmbytje shembullore, paqka se prepotenca dhe arroganca e eskortave të liderëve serbë tejkalon shumë herë detyrat e tyre. Në plot raste autoriteteve serbe u është akorduar leja e kërkuar, por të gjithë ata nuk kanë lënë rast pa humbur, për të shkelur haptazi lejen dhe qëllimin për të cilin edhe e kanë marrë atë. Kulmi kanë qenë dy raste, të cilat SHBA dhe BE u kanë dhënë të drejtë autoriteteve kosovare. I pari që Treni Blu (si dikur ai i blinduari i Titos), të cilin serbët donin ta fusnin forcërisht në Kosovë, pasi "kishin lënë vend pa shkruar mbi të në shumë prej gjuhëve kryesore "KOSOVA ËSHTË SERBI"! Kuptohet, që dështuan me sukses të plotë. Rasti i dytë ishte kur "trimi" Marko Gjuriç, i paralajmëruar disa herë se



po shkelte statusin e tij, qëllimin e lejes së dhënë, e për më keq akoma, në të gjitha rastet propagandonte në çdo tubim e aktivitet para përfaqësuesve të pakicës serbe, se Kosova është Serbi! E pikërisht për këtë, forcat e policisë së Kosovës u shtyruan ta ndalojnë forcërisht, duke e kthyer atë nga edhe kish të ardhur.

Tani, përpara se të paraqesim shembujt e pafundme të sjelljes "qytetare" serbe, që na tregon Ivica Daçiç, ky lektor i vonuar i "qytetarisë e demokracisë" milosheviçiane, le t'i hedhim një sy jetës së këtij dashnori kameleonian të civilizimit. Ivica Daçiç, për ironi të fatit, lindi në Prizren, më 1 janar 1966. Babai ishte një oficer policie i kohës rankoviciane, kur UDB-ja ishte në apogjeun titist të raprezaljeve e terrorit fizik e psikik ndaj shqiptarëve. E ëma, Jelisaveta (Jela) ishte një shtëpiake. Ai kish edhe një motër, Emica. Transferimi i familjes në Zhitovade koinçidoi me fillimin e shkollimit të tij. Inteligjent si fëmijë, spikati veçanërisht për memorie, aq sa në një gazetë e quajturën "enciklopedia me pantallona të shkurtra". Në fëmijëri i vunë nofkën "Bučko". Këtu mbaroi edhe 8-vjeçaren, ndërsa shkollën e mesme e bëri në Nish. Të lartën e kreu në Universitetin e Beogradit për shkencë politike dhe gazetari. Ishte aktivist i njohur i Rinisë Komuniste jugosllave dhe në 1990, u bë i pari president i Rinisë Socialiste për kryeqytetin. Ai është i martuar me Sanjën dhe kanë dy fëmijë, djalin Luka dhe vajzën Andrea. Karrierist provincial, arrivist pragmatik, burrë i lëngët, që merrte formën e enës ku e hidhnin, servil ndaj shefave e prepotent me vartësit, ra shpejt në sy të bosit të bosëve, Sllobodan Milosheviçit, të cilit i duheshin të ngjashmit me Daçiçin, ndaj dhe e përkrahu të ngjiste shkallët e pushtetit, paqka se ai, ashtu i shkurtrët sic është, edhe vetë shpesh çante me bërrija mes politikaneve serbë, përgjithësisht të gjatë.

Karrierën e vërtetë e nisi teksa e bënë botues të organit jetëshkurtrë të Partisë Socialiste të Serbisë, "EPOHA". Më pas e shohim në

krye të stafit të informacionit dhe propagandës së PSS në zgjedhjet e 1992 dhe 1993. Milosheviçi dhe Mirjana Marković (bashkëshortja dinake dhe e korruptuar e tij, e strehuar politikisht dhe e garantuar financiarisht nga Putin) e mbanin afër Daçiçin, duke i dhënë edhe zyrë në selinë e PSS, apo funksione në organet e zgjedhura të pushtetit për kryeqytetin. Ata ndiqnin me vëmendje ambicet për pushtet të këtij provinciali me pamje konviktore, duke e përdorur gjatë spastrimeve në parti dhe e caktuan në disa prej bordeve më të rëndësishme të propagandës, si atë të TANJUG-ut, madje edhe në krye të Këshillit Drejtues Federal të Radio Televizionit Jugosllav. Në 10 shkurt të 2000 zgjidhet në krye të PSS për Beogradin. Revolucionin "Buldozeri" i 5 tetorit 2000, që nisi, çoi në arrestimin e Milosheviçit më 31 mars 2001 dhe transferimin e tij në Hagë për ta gjykur si kriminel lufte. Ashtu si Fushe-ja dhe Talejran-i, edhe Daçiç nuk i tradhontonte miqtë, ai vetëm i braktiste ata, kur nuk i duheshin më! (për koincidence prej vitesh, ai i ka mbajtur të dy funksionet, ministër i Brendshëm si Fushe dhe i Jashtëm si Talejran!). Në zgjedhjet presidenciale të 2004-ës shfaqet si kurrë më parë kameleonizmi dhe etja e papërmbytur për pushtet e tij, teksa kandidon duke dështuar me sukses të plotë, pasi me vetëm 4.04% të votave (125.952), zuri vendin e pestë. Por Daçiç nuk ndalet. Në Kongresin e VII të PSS, mbajtur në 4 dhjetor të 2006-ës zgjidhet kryetar i saj, duke mundur në raundin e dytë Milorad Vuçeliçin me 1287 vota, kundrejt 792 votave që mori i dyti. Në 2007 zgjidhet në krye të Komitetit të Sigurisë së Parlamentit, ndërsa në 7 korrik 2008, zgjidhet zv.kryeministër i parë dhe ministër i Brendshëm. Në gusht të 2010-ës, Daçiç e familja e tij vihen nën mbrojtjen e policisë, pas dyshimeve të Shërbimit Sekret, të konfirmuara dy vite më pas, se mafia serbe, saktësisht superposi i drogës Darko Šarić, ofronte 10 milionë euro për vrasjen e Tadiçit dhe Daçiçit, si kurrë të koalicionit qe-

veritar. Këtu është vendi të kujtojmë se mafia serbe e përbërë kryesisht nga ish-oficerë të forcave speciale dhe policisë sekrete të Milosheviçit, e lidhur me politikanë dhe oligarkë, njohur ndryshe si "Klani i Zemunit", vranë më 12 mars të 2003 në Beograd, kryeministrin Zoran Xhinxiç, mafie kjo që vetëm pak ditë më parë vrau edhe një prej avokatëve të Milosheviçit, Dragoslav Ognjenović. Në zgjedhjet e 2012, PSS mori 14.53% të votave, duke u detyruar të bëjnë koalicion me Partinë Progresiste Serbe (PPS) të Tomislav Nikoliçit dhe me parti të tjera. Nikoliç merr Presidencën, Daçiç Qeverinë dhe Jorgovanka Tabakoviç, Parlamentin. Në zgjedhjet e 2014, fituar nga Partia Progresiste e Aleksandar Vuçiciç, në aleancë me të, Daçiç ndron pozicionin, duke i lënë fituesit postin e kryeministrit dhe vetë mban atë post që ka edhe aktualisht, atë të zv.kryeministrit të parë e ministrit të Jashtëm. Në zgjedhjet presidenciale të prillit 2017, Vuçic kandidon dhe fiton me 55% të votave, duke i lënë postin e kryeministrit, Ana Brnabić-it. Nikoliç, ky varrimhës, pasardhës i kriminelit Sheshelj, kontribui për ta futur sa më thellë në varr edhe vetë ish-Jugosllavinë. Në 17 shkurt të 2008, siç dihet, Kosova u shpall e pavarur edhe de jure, se de facto kishte gati 10 vite e tillë. Daçiç, në qëndrimin ndaj Pavarësisë së Kosovës, pak a shumë i ka qëndruar linjës intransigjente të politikaneve serbe të të gjithë krrahëve të mos e pranuar njohjen Kosovës si një shtet independent, paqka se Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e njohu si të ligjshëm Aktin e Pavarësisë dhe rrëzoi padinë serbe për paligjshmëri, duke nxjerrë zbuluar, si jo në pak raste, Serbinë, që vajti të vinte vetulla dhe nxori sytë (kujtoni këtu edhe vendimin përfundimtar të KAS, që dënoi Serbinë pas ndeshjes së futbollit në Beograd me përfaqësuesen e Shqipërisë). Sot Kosova njihet si shtet i pavarur nga 115 vende të botës. Daçiç në 2011 akuzonte qeverinë e Kosovës për incidentet në veri të saj, madje i quante provokime për të penguar Serbinë të aplikonte për praninë në BE! Megjithatë, atij i duhet njohur

"merita", që pranoi i pari nga serbët propozimin e SHBA e Brukselit për të takuar Thaçin e për të biseduar mbi normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Kjo ndodhi në muajt e parë të 2013-ës dhe vazhdon edhe sot, por pa arritjen e ndonjë rezultati të dukshëm, e kjo për faj të serbëve, të cilët, të iltastuar nga Europa për 100 vite, i rrinin shqiptarët e nuk i linin të qanin, ndërsa sot qajnë, pa i rrahur askush!

Le të kthehemi tani, te qëllimi kryesor i këtij shkrimi, pra te leksionet serbe për qytetari, kinse diametralisht e kundërt kjo, me sjelljen e autoriteteve të Kosovës në rastin Marko Gjuriç! Këtu është me vend të kujtojmë se "Bučkoja" Daçiç, veç kësaj nofke të fëmijërisë së tij, ka mbajtur edhe nofkën tjetër, mëse sinjifikative, "Sllboja i vogël". Në rolin jashtëzakonisht të vështirë të mbrojtjes dhe justifikimit të krimeve të luftës dhe genocidit Serb, nga makina ushtarako-policore e kasapit të Ballkanit, Sllobodan Milosheviçit, si zëdhënës i tij, ai "shkëlqeu" vetëm si demagog, gënjeshtar dhe mashtrues. Ky farë enciklopediku me pantallona të shkurtra, që kish fituar edhe konkursin panjugosllav "Tito, Revolucioni dhe Paqja" mes 600 adoleshentëve të tjerë, kur filloi të merrej me politikë të madhe, u "sëmur" nga amnezia historike, siç rëndom ka ndodhur me politikantë, diplomatë, akademikë dhe historianitë shovën serbë. Më poshtë, po përiqemi t'ia freskojmë kujtesën "Bučko" Ivica për të vërtetuar se sa me "qytetari" janë sjellë serbët, për shekuj, dekada e vite të tëra, veçanërisht kjo ndaj shqiptarëve.

Slavët, mes tyre serbët, në Ballkan u shfaqën të ardhur nga stepat e thata apo tundrat moçalore rreth shekujve VI-VII, kur prej shekujsh në këto treva jetonin prelazgët, e pas tyre, ilirët, helenët, thrakët, dakët, maqedonët (ata të Filipit, Aleksandrit të Madh etj.). Qytetërimi i lartë i tyre është tashmë i vërtetuar dhe i argumentuar katërcipërisht nga shkencat e antropologjisë, arkeologjisë, historisë, gjuhësisë, etnografisë etj. Shkroda, Durrësi, Berati, Apollonia, Butrinti, Bylisi, etj., në trojet tona ishin qytete të zhvilluara me urbanizim, vepra arti e monumente madhështore. I kënduari Daçiç enciklopediku, duhet të ketë lexuar për Lekën e Madh, Pirron, Teutën, Gentin, Bardhylin, Agronin etj., që jo rrallë fituan mbi helenët apo romakët, kur për serbët, askush nuk dinte gjë. Ekspansioni sllav në Ballkan erdhi me zjarr, me hekur, apo edhe me ortodoks të dhunshme, duke shndërruar tempujt paganë dhe objektet e kultit kristian katolik, në kisha e manastire ortodokse serbe. Kjo veçanërisht e theksuar në trojet iliro-arbërore. Daçiç i di mirë se përballë rrezikut të madh të pushtesve të rinj otoman, prësisht arbëresho-shqiptarë u bashkuan koalicionit ballkanas, në një nga betejat më të mëdha të shekullit XIV, asaj të Fushë-



Kosovës në qershorin e 1389-ës dhe se vrasësi i Sulltan Muratit të I ishte një shqiptar, Milosh Nikolla Kopiliq (1350-1389), nga fshati Kopiliq i Drenicës së Epërme, emrin ortodoks të të cilit, të parët e tij, po ka mjeshtra sa këta të sotëm, duan ta paraqesin si sllav. Po pse sllavë ishin krerët shqiptarë që morën pjesë në betejë, si Gjergj Balsha II, Dhimitër Jonima, Teodor Muzaka, Gjon Kastrioti, Andrea Gropa etj?! Le të gjejnë serbët një hero kombëtar, të përmasave europiane si ai i Gjergj Kastriotit?! Klerikët serbë ortodoksë përdorin thikën dhe helmën në shekuj, duke ndryshuar forcërisht toponimet iliro-arbërore, po ashtu si dhe pushtesit otomanë pas tyre.

Në shekullin XIX, serbët ringjallin mitin e betejës së Fushë-Kosovës, lënë në harrësë mbi tre shekuj. Ata, të mbështetur te toponimia dhe antroponimia e ndryshuar dhunshëm prej tyre apo osmanëve domin t'paraqitnin shqiptarët si të ardhur me turqit, por tri mendje të shquara të kohës, veç të tjerash, i hedhin poshtë përfundimet e vonuara "shkenore" serbe. Ami Bue, (frëng), Spenser, (britanik) dhe Hahn, (austriak), në gishtënjë e parë të shek. XIX, vizituan dhe treguan ku janë trojet shqiptare. Teksa Turqia dobësohej dhe serbët fituan autonominë e më pas pavarësinë, gjithnjë me mbështetjen e mëmës Rusi, shfaqën haptazi pretendimet mbi trojet shqiptare. Kongresi i Berlinit, 1878 e sidomos Konferenca e Ambasadorëve në Londër, (dhjetor 1913), përgjysmuan territorin shqiptar në favor të fqinjëve. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, qershor 1878, që shpalli autonominë, u "harrua" nga Europa e kohës. Gjatë gati 35 viteve serbët, sidomos në Veri të trevave shqiptare, kryen krime të përbindshme, të cilat Daçiq mund t'i gjejë lehtësisht në veprat e shumë autorëve serbë, ku shquajnë dy prej tyre, historianë që guxuan të thonë e të shkruajnë të vërtetat e tmerrshme mbi krimet e përbindshme të shovenëve serbë, Dimitriç Turovciq dhe Dubravka Stojanoviç, e meqenëse mbahet edhe si anglisht-folës, le të lexojë Aubrey Herbert, diplomat in e shqar britanik, në "The Times" të Londrës e gazeta të tjera në shtator-tetor të 1913-ës. Le të pyesë Daçiq si dhe kush i vrau legjendarin e kryengritjeve të mëdha anti-turke e antiserbe (Ded Gjo Luli, Mehmet (Sokol) Shpendi dhe Is Boletini! A e di Daçiq se kush i dogji tri herë kullat e Ndrëve të Dibritë më 1913, 1918 dhe 1921?! A ka dëgjuar gjë për kryengritjet e mëdha antiserbe të Dibritë dhe legjendën që i udhëhojë ato, Elez Isuf Ndreu? Barbaritë e serbëve që vranë, prenë, dogjën, shkatërruan çdo gjë, përdhunuan gra e vajza, u ngulën bajonetat grave shtazëna, ishin aktet e "qytetarisë" serbe, për të cilat na jep leksione sot Ivica i Sllobos! Edhe mes dy luftërave botërore nuk reshën krimet dhe deportimet e dhunshme të shqiptarëve nga serbët e "qytetëruar".

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët në Jugosllavi e patën vështrinë të binden për të ashtuquajturin Vëllazërim-Bashkim, (Bratsvo-Jedinstvo) mes popujve, që predikoi komunizmit e Titos, pas të cilit shkollonte edhe Enver Hoxha, servilli më i pesh-tirë i tij, deri në neveri dhe i të deleguarve të PKJ, Popoviç e Mugaša, Jovanoviç e Tempo, Stojniç e Dizdareviç etj., etj. Autoritetet italiane dhe gjermane të pushtimit duke njohur urretjen e akumuluar të shqiptarëve ndaj sundimit të gjatë e të egër serb, e shfrytëzuan në interes të tyre këtë, nisur edhe nga fakti që ata shpallën bashkimin e trojeve shqiptare dhe vendosën administratën vendëse po me shqiptarë, e hapën kudo shkollat shqipe. Komuniztët



jugosllavë, s'mund ta pranonin kur- rë këtë, ndaj dhe nacionalizmin për një Shqipëri etnike dhe refuzimin për t'u vëllazëruar me komunizmin e inkuadruar në njësitë luftarake të armatës së Titos, nuk ia haruan lehtë dhe s'ua falën kurrë shqiptarëve. Dhe më kriminal e më tragjik është masakra e Tivarit, e 1 prillit 1945, kur u masakruan pabesisht mijëra shqiptarë të mobilizuar me forcë nga armata jugosllave, në prani të njësie partizane të UNCSH, që i shoqëronin. Kryekriminali stalinist Enver Hoxha priti gati 40 vjet ta denoncon të këtë masakër të tmerrshme, në pamfletin "TITISTËT", paçka se kishte rreth 35 vite që ishte "prishur" me Titon. Kjo masakër e ngjashme me atë të Katinit në Poloni me urdhër të Stalinin, ishte pranuar në dokumente zyrtare të Udhëheqjes titiste, e më pas gjatë raportimit para Kongresit të PKJ në maj të 1945 nga vetë famëkeqi Rankoviç, i cili ndryshe nga ç'shkruhej në dokumentin zyrtar, ka pranohet eliminimi i 420 djemve të rinj kosovarë, e uli në rreth 300 numrin e tyre, duke zvogëluar me disafish numrin e tyre!

Krimet serbe nuk reshën edhe gjatë 35 viteve të sundimit të Marshal J.B.Titos. Nën pretekstin e mbledhjes së armëve, u eliminuan, u torturuan mizorisht, u burgosën e u internuan mijëra shqiptarë. Pas shkarkimit të Rankoviçit serb (1966), fajet iu mvëshën atij, por i sofistikuar antishqiptar Tito, nuk e ndali represionin. Kështu, me gjak e dhunë u shtypën demonstratat e 1968 për flamur, autonomi e universitet, që detyruan Titon nga frika e ndonjë revolte më të madhe mbarëshqiptare, që më fund t'i pranonte. Fill pas vdekjes së tij (4 maj 1980), shpërthyen në Kosovë, demonstratat e pranverës '81, me kërkesë kryesore, "KOSOVA REPUBLIKE", ku mbetën dhjetëra të vrarë, pas të cilave filloi procesi posh-tërues i "DIFERENCIMIT", një lloj apartejdi racist antishqiptar, i cili goditi egërsisht intelektualët, akademikët, profesorët universitarë, arsimtarët, gazetarët, shkrimtarët, artistët deri dhe sportistët, thjesht një neotalinizëm i pastër. Dhe "Tirana zyrtare, për turpin e saj heshti rreth një muaj, deri kur në gazetën "Zëri i Popullit" publikohen dy artikuj mbi ngjarjet në Kosovë, nënshkruar me pseudonimin Arbër Korabiç, që as më shumë e as më pak ishte dora vetë ai, burraçaku dhe frikacak Enver Hoxha!

Në skenën politike jugosllave, po ngjitej ylli i Sllobo Milosheviçit, që kremtonte plot "madhësi" në qershorin e 1989, humbjen. (600-vjetori i betejës së Kosovës). Stalinisti i fundit në Europë mori jo rastësisht, për zëdhënës të tij, "Buckon" Ivica. Detyrë e vështrinë kjo, të mbrohej e

të justifikohesh një paranojak hysterik, që vuante nga deliri i madhësishtë e protagonizmit, të mbrohej e justifikohesh diktatori më i egër i Ballkanit, që shkatërroi me luftë Jugosllavinë, vrau dhjetëra mijëra njerëz në Vukovar, Srebrenicë, Reçak etj., duke kryer gjenocid, krime lufte, përdhunime e deportime të tmerrshme në Bosnjë, Kroaci e Kosovë. Por ai, me gjithë përpjekjet dhe artin e tij të demagogjisë, nuk e shpëtoi dot shef Sllobon, i cili nga Pallati i Bardhë i mbretërve në Beograd, i arrestuar, u transferua në Holandë, shumë afër Pallatit Mbretëror në Hagë, në burgun e Sheveningenit të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës. Sllobo u gjyqua për krimet e tmerrshme që bënte serbët, nën udhëheqjen e tij, të Karaxhiçit, Mlladiçit, Shesheljit, Arkanit e të tjerëve, por vendimin përfundimtar me vdekje, Sllobodanit, ia dha i "Plot-fuqishmi" Arkanit e Cecas e vranë në mes të Beogradit, ish-miq të dikurshëm të supermafias serbe, ndërsa tre të tjerët e sipërmendur, (si dhe shumë të tjerë kriminalë serbë), u dënuan me afate të gjata burgimi.

Në Kosovë, të shtunën e 23 dhjetorit 1989, një grup intelektualësh, akademikë, profesorë universitarë, shkrimtarë, gazetarë dhe studentë me Ibrahim Rugovën në krye, të frymëzuar edhe nga legjenda e burgjeve Adem Demaçi, themeluan Lidhjen Demokratike të Kosovës, e cila që e para parti politike demokratike në gjithë Lindjen komuniste. Kjo, pas suprimimit nga Milosheviç në mars, të Kushtetutës së 1974-ës, që i njëjti autonominë e shumë liri e të drejta shqiptarëve. Edhe pse LDK e lideri historik i saj dhe i Kosovës, Dr. Rugova u shprehën në mënyrë eksplicite për Kosovën Republikë, ata ishin për rrugën paqësore të mbërritjes së qëllimit final, në 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës shpalli Republikën e Pavarur dhe miratoi Kushtetutën e re, ndërkohë që më 7 shtator 1991 referendumi me mazhorancë absolute e njohu pavarësinë. Në 1992 zhvillohen zgjedhjet presidenciale e parlamentare dhe Rugova zgjidhet president. Serbia "qytetare", gjithnjë sipas Daçiq-it, i tregon dhembët, s'kish bërë edhe me grevat e minatorëve të Trepçës e Stari-Tërgut, mbyll shkollat e universitetin dhe komandon në krye të këto institucioni drejtues serbë. Shqiptarët dhe qeveria e Dr. Bujar Bukosh-it, hapin shkollat paralele që mbahen me 3% e të ardhurave të qëdo emigrantit. Milosheviçi nuk priti më gjatë, por dërgoi ushtrinë, policinë, tanket dhe blindat. Kjo që rruga "demokratike e qytetare" e Sllobos të cilës shqiptarët paqësorë iu përgjigjen me krijimin e FARK-

ut, ndaj të cilit qeveria shqiptare dhe Presidenti Berisha dhanë mbështetje të fuqishme, më pas edhe UÇK, ku shquante komandant legjendar Adem Jashari, njësitë luftarake të së cilës, po rriteshin e forcoheshin nga dita në ditë, deri sa në fund të luftës mbërritën deri në 20.000 luftëtarë. Lufta u zhvillua gjatë 15 muajve: 28 shkurt 1998-11 qershor 1999, ku vendimtare ishte ndërhyrja ushtarake e NATO-s, sidomos bombardimet e saj deri edhe mbi Beograd. Serbëve nuk u bëri punë as ndihma e gjithanshme ruse në logjistikë e armatime, e sidomos me mercenarë kriminalë të degraduar si pijanecë e drogmenë. Mes shumë betejave, beteja dhe fitorja më e madhe gjatë luftës, ishte ajo e Kosharës.

Tetë masakrat më të mëdha të serbëve në Kosovë ishin: e Prekazit (56 Jasharajt), Reçakut, (45 të masakruar, denoncuar botërisht nga ambasadori amerikan i OSBE William Walker), Izbicës, Reçallës, Dubravës, Krushes së Madhe (Rahovec), Rugovës së Hasit dhe ajo e Studimes (Vushtrri).

Pasojat e krimeve serbe: 11 843 të vrarë (1.392 fëmijë dhe 1.739 femra). Dëshmorë 2.261, 68 nga Shqipëria; ende të pagjetur 1.450 shqiptarë; u dhunuan 20.400 femra. U shkatërruan 188.000 ndërtesa (shtëpi, shkolla, biblioteka, qendra shëndetësore, xhami, kisha katolike) dhe u deportuan me dhunë 782.100 njerëz.

Daçiq "po bën petulla" për një ndarje të Kosovës dhe me shefin e ri, Vuçiq (një tjetër kameleon politik serb ky, i rilindur, pasi ishte ndër më konfidentët e kriminelit Sheshelj) zgjasin pa fund biseditet e Brukselit! Ana Brnabiçin e kanë lënë të merrret me hallt e mëdha që kanë shoqatat e LGBTI (si e dyta kryeministre e Serbisë, pas Petar Zivkoviçit (1879-1947) e deklaruar gay. Nuk dihet çfarë duhet t'i ketë thënë Ues Micell atij (se Sekretari Pompeo s'pati kohë ta priste), apo nëse ia mori këngës në Uashington këto ditë, si para "Sulltan" Erdoganit, vëllait mysliman të kryeministrit tonë ortodokso-katolik, por një gjë dihet mirë: Kosovën nuk ka forcë që ta ndajë! Presidenti Trump, e di mirë si vihen në rresht Kim-ët e Koresë, Ruanët e Iranit, apo këta Vuçiqët e Daçiqët dhe gjithë HIÇËT e tjerë të Serbisë. Këtë shkrim po e mbyll me një pyetje: a mund të na japë përsëri leksione demokracie e qytetarie nga serbët Ivica Daçiq?!

(Historian dhe diplomat i karrierës, Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare i Partisë Demokratike)

## HOROSKOPI

**DASHI**

Sot do të ndiheni plot energji. Mos u sillni ashpër me të afërmit, pasi mund të prishni qetësinë në familje. Sot do të ndjeni mungesën e një mikut tuaj. Dëshimet rreth partnerit/partneres do t'ju çojnë drejt një zënke të madhe.

**DEMI**

Keni nevojë të relaksoheni dhe përqipuni të gjeni lumturim mes miqve tuaj të ngushtë dhe anëtarëve të familjes. Ndihmoni partnerin/partneren tuaj për disa çështje, pasi do të ketë shumë nevojë. Sot do të bëheni nostalgjik duke kujtuar kohët e vjetra.

**BINJAKET**

Aktivitetet e shumta fizike do t'ju lodhin dhe stresojnë. Disa përgjegjësi familjare do t'ju shkaktojnë tension. Mos i tregoni informacionet personale. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj dhe do të ndihni shumë të dashuar. Mos shpenzoni shumë kohë para kompjuterit, pasi do të ndiqnë negativisht në shëndetin tuaj.

**GAFORJA**

Disa probleme shëndetësore do t'ju shqetësojnë. Sot do të keni mundësi të fitoni para, por mija e shpenzimeve nuk do t'ju lejojë të kurseni. Ka ardhur koha për të ndryshuar sjelljen dominuese në shtëpi dhe të bashkëpunoni me të afërmit tuaj. Kjo do t'ju sjellë ata pa fund. Mos e shpenzoni kohë për gjera të kota, por shfrytëzoni për aktivizetë të shumëllojshme.

**LUANI**

Sot do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore. Përqipuni të tregoni shumë kujdes për çështjet bankare. Të afërmit tuaj do të mërziten nëse nuk kaloni më shumë kohë me ta. Gjatë një pjese të ditës do të merreni me rregullimin e disa punëve të lëna pas.

**VIRGJERESHA**

Egoizmi i një mikut tuaj do t'ju shqetësojë shumë. Do të arrini një marrëveshje të re financiare, e cila do t'ju sjellë mjaft të ardhura. Sot nuk do të keni shumë durim, por bëni kujdes me fjalët, pasi mund të lëndoni njerëzit rreth jush.

**PESHORJA**

Përqipuni të çlirohni nga stresi. Meditimi dhe joga mund t'ju ndihmojnë shumë për t'u ndryshuar të relaksuar. Disa probleme financiare ka gjasa t'ju çojnë drejt zënkeve. Do të kaloni një moment të vështirë me familjarët. Partner/partnerja juaj do kujdeset shumë për ju. Sot do t'ju vijnë ftesë nga një burim i papritur.

**AKREPI**

Mos lejoni që natyra juaj e paparashkueshme të prishë marrëdhëniet martesore. Përqipuni ta shmangni një gjë të tillë, përndryshe do të pendoheni më vonë. Bëni kujdes se më ke bashkëpunoni sa u përket çështjeve financiare! Bëni kujdes nga disa miq!

**SHIGJETARI**

Sot do të jeni shumë të shqetësuar. Bëni një shtetje, thithni ajër të pastër dhe çlirohni. Nëse mendoni pozitivisht, gjithçka do të jetë më e lehtë. Kë gjasa që të realizoni një udhëtim shumë të këndshëm. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita më e bukur në jetën tuaj.

**BRICJAPI**

Do të ndiheni në gjendje shumë të mirë shëndetësore, pavarësisht se do të kaloni një ditë të tensionuar. Partner/partnerja do të tregohet shumë e vëmendshme ndaj jush. Nëse i koncretizoni gjërat, do t'ju vlejë shumë për të ardhmen.

**UJORI**

Natyra juaj dëshyese mund t'ju çojë drejt humbjes. Mos shpenzoni shumë para për argëtim. Sot do të befasoni nga një veprim i partner/partnerit. Do të kaloni një pasditë të këndshme me miqtë tuaj.

**PESHQIT**

Do të shprehni nga një sëmundje nga e cila vuanit prej kohësh. Fëmijët dhe familja janë fokus i ditës. Do të kaloni një ditë shumë të bukur me gishtënjë tjetër të zemrës suaj. Mos humbni asnjë mundësi që iu del përpara, pasi do të jetë shumë e vlefshme për të ardhmen.

# Historitë e grave të përdhunuar

Nga "The Guardian"

Një artiste, një aktiviste dhe një ish-presidente kanë ndihmuar në arritjen e një fitoreje historike për mijëra kosovare, pajtimin e shtetit që t'i paguajë pensionet për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kur kishte nisur lufta në Kosovë, Feride Rushiti ishte duke studiuar mjekësi në Universitetin e Tiranës në Shqipëri. Pasi u specializua, filloi të punojë si vullnetare për të trajtuar viktimat civile të konfliktit. Në marsin e vitit 1999, ajo udhëtoi nga Kukësi, kufiri me Shqipërinë, ku qindra mijëra refugjatë ishin mbledhur për të ikur nga spastrimi etnik që po bënin forcat serbe. Ishte e pashpresë, konfuze dhe zemërthyer, thotë ajo për gazetën britanike "The Guardian", ndërsa flet për "eksdonim më të madh që kish të ndodhur në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore". Rushiti, shqiptare nga Gjilani, ka punuar gjatë ditës me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe gjatë mbremjeve me "Doktorët pa kufij". Pavarësisht kaosit të ditëve të para, ajo takoi një grua, historia e së cilës do të ia ndryshonte jetën prej atij momenti e tutje e që do të lidhej edhe me tregimin e qindra e mijëra grave të tjera kosovare. Gruaja sapo kishte abortuar. "Dhe ajo nuk kishte një shans për të varrosur fëmijën", thotë Rushiti. "Ishte e vështirë të dija se si ta mbështesja. E pyeta se ku ishte burri i saj. Ajo tha: 'Ata e morën burrin tim'. Në atë moment fillova të qaja. Por britma e saj ishte e paimaginueshme, nuk kisha dëgjuar kurrë një tingull të tillë. Mbahta atë dhe nga ana tjetër po përipqesha ta mbyllja tendën, pasi kishte njerëz jashtë. Ajo ishte përdhunuar". Rushiti, asokohe 28 vjeçe, kishte shpenzuar kohën më të madhe të viteve të '90-të duke studiuar mjekësi në fshehtësi në Kosovë, në institucionet paralele, pasi serbët mbyllën institucionet arsimore dhe institucionet e tjera për shqiptarët etnikë. Por në Kukësi ajo u kthye studimeve dhe u përqendrua të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. "Nga gjërat që po shihja, nga tregimet që dëgjova, nuk mund të imagjinoja se qeniet njerëzore do të bënin gjëra të tilla. E dija se duhej të mendoja përtej profesionit tim si mjekje. Duhej të isha zëri i tyre. Nuk ishe vetëm trauma psikologjike që e goditi, por në shoqërinë thellësisht patriarkale të Kosovës, përdhunimi u pa si një njollë në nderin e familjes dhe pengesa të mëdha të stigmeve dhe fajit ishin përpara", thotë ajo për "The Guardian". Pas marrëveshjes së paqes të

"The Guardian": Lufta për të drejtat e viktimave të dhunës seksuale



qershorit 1999, Rushiti themeloi Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT). Një vit më pas, "Human Rights Watch" përkshkroi përdhunimin e përhapur të përdhunimit, shpesh përdhunimit nga ana e policisë, paramilitarëve dhe ushtarëve serbë të udhëhequr nga Sllobodan Milloseviç si një "mjet spastrimi sistematik etnik", për të poshtëruar, terrorizuar dhe zhvendosur shqiptarët etnikë. Shumë të mbijetuarat u braktisën nga burrat e tyre, madje edhe në ishin të izoluar dhe të heshtur. Vlerësimet ndryshojnë, por disa burime kanë pohuar se deri në 20,000 gra (dhe disa burra) ishin viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës. Në vitet menjëherë pas kësaj, askush nuk donte të fliste për këtë - thotë Rushiti. "Unë do të shkoja në komunitete, por të gjithë do të thoshin: 'Askush nuk u përdhunua këtu, përse po flet për këtë gjë?' Aksionet ishin shumë të larta. Burrat nuk donin që gratë dhe vajzat e tyre të flisnin për shkak të stigmeve dhe sepse do të praninin se nuk kishin mundësi t'i mbronin", ka treguar ajo për "The Guardian". Rushiti hapi qendra në komunitetet më të prekura për të trajtuar plagët fizike, përpara se të krijonte mjaft besim për të trajtuar ato psikologjike. Puna e saj nuk ishte pa rrezik. Ajo u paralajmërua kundër hapjes së një qendre në Skenderaj, në Drenicë, një nga zonat më të varfra të Kosovës dhe një bastion i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mes shqetësimeve se ajo do të kërcënohej apo do të rrihej. "Trokisja në derën e një shtëpie, duke kërkuar hapësirë për zyre dhe ata thanë: 'Kush është shefi juaj? Më sillni një burrë'. Ishte e tronditur. Nuk mund të besoja se po ndodhte ky diskriminim". Dhuna në baza gjinore mbe-

tet e zakonshme, një studim i vitit 2015 tregoi që deri në 68% e grave kosovare përtojnë dhunë në familje, shkruan "The Guardian". "Nëse dikush do të më pyeste tani se a do ta bëja këtë punë, unë do të thosha jo - shprehë Rushiti. Nuk i njihja rreziqet. Ishte e re dhe e pasionuar. Por ngadalë, gratë filluan të kërkonin trajtim. Sot QKRMT ka më shumë se 400 gra nën trajtim". Ndërkohë që QKRMT-ja dhe OJQ-të e tjera të Rushitit kanë ndihmuar në thyerjen e heshtjes gjatë dhunës seksuale në kohën e luftës, asnjë i mbijetuarit kurrë nuk kishte folur publikisht deri në vitin e kaluar, kur Vasilje Krasniqi, një kosovare që jeton në Dallas ka postuar në faqen e saj në "Facebook" një letër të hapur për një njeri që e rrëmbëu dhe e përdhunoi atë. Krasniqi u mor me armë nga shtëpia e saj më 13 prill 1999 nga një burrë me uniformë. Në letërën e saj, ajo kujton se si ajo i kërkoi atij që ta vriste në vend. "Ti më lëndon. Ishte 16 vjeç dhe nuk e kisha përjetuar jetën. Ishte e pafajshme". Duke folur për një gazetar për herë të parë, Krasniqi, 36 vjeçe, thotë nëpërmjet "Skype" se ajo e shkroi letërën për të inkurajuar të tjerët. "Nuk më vjen turp dhe nuk kam frikë. Unë do të bëj pjesën time. Të gjithë e dinin se një polic serb më mori. Të gjithë e dinin që ju nuk merrni një vajzë 16-vjeçare për të marrë një deklaratë". Që nga postimi i saj në "Facebook", Krasniqi është bërë ambasadore për të mbijetuarit e luftërave të tjera. Muajin e kaluar, ajo foli me gratë nga Iraku dhe Republika Demokratike e Kongos në OKB në Gjenevë dhe së shpejti do të udhëtojë në Korenë e Jugut për të biseduar me të tjerët, që u përdhunuan në shtëpitë ushtarake japoneze gjatë Luftës së Dytë Botërore. "Ishte shumë emocionuese -

thotë ajo për udhëtimin e saj në Gjenevë. - Ishim nga prejardhje, kultura dhe fe të ndryshme, por të gjitha kemi të njëjtat histori, me stigme dhe fajin. Kjo e shkatërron zemrën time". Atifete Jahjaga, presidente Kosovës nga 2011 deri në 2016 kujton një "debat të keq" në parlament në 2013-ën, si një pikë kthese personale. "Unë isha duke parë TV në zyrë", thotë ajo duke shpjeguar se presidenti lejohet në parlament vetëm një herë në vit, nëse nuk ftohet. Ndërsa politikanët debatuan nëse definicioni i një veterani të luftës duhet të zgjerohet për të përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale. Ligjvënësit sugjeruan se ata duhet t'u nënshtrohen testeve gjinekologjike - një masë që shkaktoi zemërim midis aktivistëve. "Fika televizorin dhe i thashë ekipit tim të këshilltarëve: 'Behuni gati'. Do të ketë një luftë të hapur midis presidencës, institucioneve të vendit tonë dhe publikut", transmeton "KP". Në një demokraci parlamentare, presidenti i Kosovës ka një rol kryesisht ceremonial. Por Jahjaga, më parë zëvendës drejtore e policisë së Kosovës, e përdori platformën e saj për të nxjerrur kompensimin. Në vitin 2012 ajo kishte pritur një samit ndërkombëtar që çoi në parimet e Prishtinës, i cili afirmoi të drejtat e grave për pjesëmarrjen politike dhe ekonomike, si dhe qasjen në sigurinë dhe drejtësinë. Ndër prioritetet e saj ishte njohja e të mbijetuarve të dhunës seksuale. "Unë nuk dua që kjo të jetë një subjekt tabu - thotë ajo. - U thashë njerëzve: 'Kjo është nëna jote, motra jote, vajza jote'. Si shtet, është obligim ynë të trajtojmë burra dhe gra që kanë vuajtur lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi në mënyrë të barabartë. Ne kemi njohur vuajtjet e veteranëve të luftës, heronjve. Por në një vend ku ka kaq shumë fusha

të betejës, këto trupa të grave u kthyen në fusha të luftës nga forcat paraushtarake të Serbisë. Edhe ato janë edhe heroinat tona", thotë ajo për "Guardian". Pati edhe një tjetër kthesë një vit më vonë, në 2015, kur artistja Alketa Xhafa Mripa zbuloi instalimin e saj "Thinking Of You" (Mendoj Për Ty) në stadiumin e futbollit në Prishtinë. Jahjaga, këshilli i së cilës sponsorizoi veprat e artit, e përshkruan atë si "një cast #MeToo", që bëri tituj në mbarë botën. Mijëra veshjet e dhuruara nga të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe të tjerëve u varën në tela rrobash, një kujtim i fuqishëm i luftës, si dhe simbolizmi i larjes së stigmeve. Tani 37 vjeçe, Xhafa Mripa u largua nga Kosova në vitin 1997 për të studiuar art në "Central Saint Martins" në Londër me burrin e saj. Ajo kujton se kishte dëgjuar për përdhunimin në periudhën e luftës menjëherë pas konfliktit. Por njerëzit nuk kanë folur për këtë. Vite më vonë, ndërsa vizitoi familjen në Kosovë, ajo dëgjoji një intervistë televizive me një grua që fliste për luftën. Fytyra e saj ishte e fshehur nga një perde. Ajo foli për heshtjen rreth dhunës seksuale të kohës së luftës. "Mendova, o Zot ime, si mund të dësh-tonim njerëzit më të brishtë në shoqërinë tonë? Ata përjetuan luftën dy herë dhe vuajtën më së shumti. Kur të gjithë u çliruan dhe po festonin, zërat e tyre nuk dëgjoheshin". Çfarë kujton kur mendon për Kosovën? "Më kujtohet mikpritja, solidariteti dhe ngrohtësia e njerëzve. Kosova është shtëpia ime dhe unë u rrita me natyrën. Por gjithnjë kishte luftë dhe frikë, njerëzit u shpëtyn. Unë shoh fëmijët e mi që i shprehin mendimet e tyre lirshëm. Fëmijëria ime ishte e lumtur, por në ishim gjithmonë të frikësuar se çfarë mund të ndodhte. Ishte sikur të ishte nën pushim. Çdo ditë kishte frikë". "Ka shpresë për Kosovën. Sigurisht, ka korrupsion dhe çështje të tjera që duhet të luftojmë, por vendi po shkon në drejtimin e duhur". Deri më tani, 600 të mbijetuarat kanë aplikuar për pension, një përqindje e vogël e mijërave që besohet se e meritojnë. Kur e pyesin Atifete Jahjagan nëse 20 vjet ka qenë një kohë e gjatë pritjeje për të mbijetuarit, ajo dëshiron që ata të kenë njohje më të madhe dhe që Serbia të kërkojë falje për krimet e saj. "Po, ishte kohë shumë e gjatë - thotë ajo. - Lufta nuk ka përfunduar kurrë për ta".

## SHKURT

Bali, tërmeti i fuqishëm

7 ballë frikëson

vendësit për cunam

Një tërmet i fuqishëm ka tronditur ishullin e Balit. Raportimet e para nga ishulli indonezian thonë se tërmeti ka qenë me magnitudë 7 ballë dhe autoritetet kanë lëshuar një paralajmërim për cunam. Nuk ka ende detaje rreth viktimave apo dëmeve të shkaktuara nga tërmeti, i cili ndodhi rreth orës 19:45 me orën lokale.

Avioni rrëzohet në

alpet zvicerane, vdesin

20 persona

Një avion i Luftës së Dytë Botërore është rrëzuar në alpet zvicerane, ku rreth 20 persona dyshohet se kanë gjetur vdekjen. Sipas medieve të huaja, avioni u rrëzua nga një lartësi prej rreth 2,500 metrash, ditën e shtunë në malin Piz Segnas në lindje të vendit. Avioni 'JU52 HB-HOT', i ndër-tuar në Gjermani në 1939, i përket 'JU-Air', raporto i agjencia e lajmeve 'ATS'. Policia konfirmoi se aeroplani rrëzuar po fluturonte nga qyteti Locarno pranë kufirit jugor të Zvicrës në Duebendorf të Zyrihut. Në avion ishin 17 pasagjerë, 2 pilotët dhe 1 mjek i fluturimit.

Evropa goditet nga vala e të


nxehtit, shkon në tre numri i

të vdekurve në Spanjë

Vala e të nxehtit që ka mbërthyer Evropën ka shkakuar tre viktimat në Spanjë. Temperaturat janë thaujse në nivel rekord dhe do të vazhdojë të jetë mbi 40 gradë celsius të paktën deri këtë diel, si në Spanjë, ashtu edhe në Portugali. Lisbona parashikohet të jetë një prej qyteteve më të nxehta në botë gjatë kësaj fundjave. Në jug të Portugalisë, qendra zjarfikës kanë luftuar me flakët në një pyll në Algarve, një destinacion popullore turistik. Dy fshatra në zonën Monchique janë evakuuar. Mbi 700 zjarrfikës kanë shkuar në vendngjarje dhe 11 avionë me ujë janë përdorur për të luftuar flakët, teksa temperaturat parashikohet se do të shkojnë deri në 47 gradë celsius. Spanja dhe Portugalia janë dy vendet që janë goditur më shumë nga i nxehti që ka përfshirë Evropën. Tre persona kanë humbur jetën në Spanjë, ndërsa në jug të Portugalisë qindra zjarrfikës po luftojnë me flakët që kanë përfshirë pyllin në Algarve.



### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

2. Një pikturë vetes.
11. Lindgren e Pippi çorapëgjatës.
13. Thirre edhe kështu Persefoni.
14. Hapin ekspozitën.
16. Ruket pa çifte.
18. Shiroka aktor.
19. Fillojnë masat.
20. Të parat në aksion.
21. Eshhtë gara më e gjatë.
25. Inicialetë Pacino-s.
26. Janë sponsor të Tiranës.
28. Pavone këngëtare.
29. Kështu thirrej Marco Pantani.
30. Dieta pa ekstreme.
32. Janë salla për projeksione.
33. Duhet çarë më ditë.
36. Italia në tabela.
37. Janë katrorë në sipërfaqe.
38. Williams teniste.
40. Në fillim të verës.

41. Cocker këngëtar.
43. Të fundit në tender.
44. Janë fletë trëndafili.
48. Fillojnë ideologjinë.
49. Eshhtë krahinë e Athinës.
51. Emri i Zola.
52. Hari spiune.
53. Janë kulla në xhami.

**VERTIKAL**

1. Njësi matëse për kondensator.
2. Artet pa re.
3. Fillojnë uraganin.
4. Nisin titrimin.
5. Janë në modë.
6. Inicialet e Kokoschka-s
7. Një mund të jetë ekspres
8. Mund të jenë ushtarake.
9. Jepen për hartim.
10. Janë të lira për hartim.
12. Eshhtë magjik ai i fatave
15. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
17. Një organizatë humanitare
21. Janë shkurre.
22. Janë kapo kozakë.
23. Nino kompozitor.
24. Fillojnë teorinë.
27. Kryqyteti i asirëve.
31. Një verë në Paris.
32. Një vepër si romani.
34. Mbyllin një sherr
35. Kompozoi një Bolero.
37. Pak mbeturina
39. Një bëhet për të mirë.
42. Eshhtë dhomë.
44. Peter që humb hijen
45. Një pjesë e territorit.
46. Pak amerikanë.
47. Gjysmë litari.
49. Dy asa.
50. Kalimi në kufij.

### Fjalëkryqi (2)


**HORIZONTAL**

1. Mondrian piktor.
5. Safin tenist.
9. Eshhtë e re pas Krishtit.
10. Janë grimca të famles së adroneve të tilla.
12. Fillojnë matematikën
13. Mbarojnë fare
14. Josa trainer.
15. Në mes të dhomës.
17. Gjysma e inatit.
19. Ishin shkolla edukimi.
22. Janë ritransmetues televizivë.
24. Ishte djali që vrau Odiseun.
25. Një pjesë e opozitës
27. Një ekspres në binarë.
29. Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
30. Mund të lakohen.
32. Një yll me bisht.
34. Italia në Internet.


35. Edouard piktor.
37. Shahu i fundit.
38. Gjysma e aortës.
40. Efekti... i François Truffaut.
41. Inicialet e Lendl
42. Kufizojnë një kënd.
44. Polanski regjisor.
46. Skuadër greke.
48. Britma e Arkimedit.
49. Egoyan regjisor.
50. Fillojnë turnin.

**VERTIKAL**


1. Ishte shkolla e Arkimedit.
2. Grandi këngëtare
3. Diftong teatral
4. I përkasin stinës së nxehtë.
5. Një shishe bombë.
6. Janë në qendër.
7. Ndiqet nga një mi
8. Janë këngëtarë lirikë.
10. Emër burri.
11. Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
15. Botom pa ekstreme.
16. Eshhtë figurë letrare.
18. Eshhtë enë kryesore gjaku.
20. Një pikë në ligj
21. Risia pa kufij
23. Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
26. Janë fletë trëndafili.
28. Robert Mitchum.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Eshhtë si fatë.
32. Gjysma e ketrit.
33. Carolina e belle epoque.
36. U shkrua nga Zola.
39. Me të bëhet trokë.
43. Duket të parat
45. Maten të parat.
47. Të parat në kufij.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR**

L	U	I	S	A	K	O	H	A	A	D
F	O	R	T	A	F	A	T	A	L	E
E	S	A	D	E	L	P	R	A	N	S
N	A	T	P	E	L	L	I	K	A	N
E	L	S	A	B	O	T	I	M	E	T
L	A	K	O	N	I	K	E	T	V	T
M	O	N	O	T	O	N	V	E	T	E
B	O	L	E	R	O	I	B	E	R	I
S	I	T	A	R	R	I	P	A	T	
P	B	I	M	E	S	T	A	A	T	
T	K	E	A	T	A	V	A	D		
N	A	T	A	M	I	A	A	P	E	
R	O	W	A	N	B	A	K	A	L	
A	B	E	L	P	N	A	I	A	R	
S	O	E	P	I	T	E	T	R	I	
A	R	A	T	R	E	T	A	T	I	
K	R	M	N	O	T	A	R	I	K	
K	E	H	P	A	M	A	D	S	H	
K	O	L	O	N	A	K	T	E	C	
T	U	N	E	L	E	T	R	E	R	
E	R	A	I	T	K	E	S	T	I	
T	A	T	S	A	R	A	H	E	F	
E	T	J	A	K	A	T	E	T	E	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

### SUDOK

1	3			6	
	7	4		2	5
			5	3	
	8		1		
			6		2
					4
		3		5	
9	3			7	4
			7	5	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	7	2	4	1	5	9	8	3
8	9	3	6	7	2	5	1	4
4	1	5	3	8	9	2	6	7
9	2	8	1	3	4	6	7	5
1	3	6	5	9	7	4	2	8
5	4	7	8	2	6	3	9	1
2	6	4	7	5	8	1	3	9
3	8	9	2	4	1	7	5	6
7	5	1	9	6	3	8	4	2

### Argëtim filozofik

- Ekzistenca e kaq shumë feve tregon mungesën e një perëndie të vërtetë brenda tyre.
- Dallimi i teorisë nga praktika, është shumë i vogël në teori, por shumë i madh në praktikë.
- Para se të kërkonin atë që u tha në lidhje me ju, mësoni se kush e ka thënë atë. E dyta është më e rëndësishme dhe përcakton vlerën dhe rëndësinë e të parës.

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6		4	6		1	4	1	7
1	15		11	8	5	6		5	L	I	M
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7	5
6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7	13
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7
6		13	3		8	13	9		12	1	
16		4	13	13	3		6	1	5	5	3
1	6	3	1	13	7		17		9	4	8
13		9	7		8	17	3	16	9	15	8
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3	8
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17

H	I	J	A			K	S		S	T	O	L
A	N	E	T			D	A	F		H	L	T
B	A	T				H	E	R	E	T	I	K
I	T					H	O	N	O	R	A	R
T						K	A	P	I	T	A	L
O	A	L				K	R	A		T	R	L
R	E	A				I	O	S	J	I	A	E
E	S	N				A	T	O	E	T	I	F
M	I	S				P	O	E	T	N	O	
N	I	K				M	L	A	M	E	N	
A	N	E				S	T	E	Z	I	S	T
T	A					B	A	R	A	K	A	I

### Thënie të mençura

- - Ëndrrat janë si mrekullitë. Dalin të vërteta vetëm kur ju i besoni ato.
- - Gjithçka që fillon me siguri, përfundon me dyshim.
- - Nuk mund të jetë diçka domosdoshmërisht e drejtë sepse është ligjshme. Duhet të jetë e ligjshme, në qoftë se ajo është e drejtë
- - Krenaria merret me "kush ka të drejtë".
- - Mençuria merret me "çfarë është e drejtë".
- - Njohurinë e pasaktë gjithmonë e ndjek një vendim i gabuar.
- - Ateistët janë njëzë të veçantë. Duhet më shumë, besim për t'u bërë ateist se sa fetar.

